



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 43

2000

Dhjetor

P Ë R M B A J T J A

Ligj nr.8690 datë 16.11.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese”	1935
Ligj nr.8692 datë 16.11.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Bonit “Për mbrojtjen e llojeve shtegtuese të kafshëve të egra” dhe mirëkuptimet e kësaj konvente.....	1936
Ligj nr.8697 datë 23.11.2000	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Greke për projektin e infrastrukturës sociale për sektorin e arsimit”	1936
Ligj nr.8698 datë 23.11.2000	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Greke për projektin e infrastrukturës sociale për sektorin e shëndetësisë”	1949

Ligj nr.8703 datë 1.12.2000	Për ratifikimin e “Konventës Europiane për informimin për të drejtën e huaj”	1960
Ligj nr.8705 datë 1.12.2000	Për ratifikimin e “Marrëveshjes Europiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore”	1966
Ligj nr.8706 datë 1.12.2000	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e pjesshme të zgjeruar të Qendrës Europiane të gjuhëve moderne”, në Graz të Austrisë.....	1971
Dekret nr.2831 datë 11.12.2000	Për lënie të shtetësisë shqiptare.....	1975
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Altë Hakorja	1976
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Gjyzel Fida.....	1977
	Kërkesë për shpallje të zhdukur të Françesk Pjetri.....	1977
	Vendim për shpallje të zhdukur të Tahir Balliu.....	1977
	Vendim për shpallje të zhdukur të Ilirian Kacaj.....	1977

L I G J
Nr.8690, datë 16.11.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN
“PËR MBROJTJEN E MJEDISIT DETAR DHE TË ZONËS BREGDETARE TË DETIT
MESDHE, SI DHE TË 6 PROTOKOLLEVE SHOQËRUESE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën “Për mbrojtjen e mjedisit detar dhe të zonës bregdetare të Detit Mesdhe, si dhe të 6 protokolleve shoqëruese”;

1. Protokoli për parandalimin dhe shmangien e ndotjes së Detit Mesdhe nga mbeturinat e anijeve dhe të aeroplanëve ose nga djegia e tyre në det.

2. Protokoli për bashkëpunimin për të luftuar ndotjen e Detit Mesdhe nga nafta dhe nga substancat e tjera të dëmshme, në raste emergjente.

3. Protokoli për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotjet e veprimtarive të vendosura në tokë.

4. Protokoli për zonat specifike të mbrojtura dhe për diversitetin biologjik.

5. Protokoli për mbrojtjen e Detit Mesdhe nga ndotja që shkaktohet nga eksplorimi dhe shfrytëzimi i shelfit kontinental, i shtratit të detit dhe i nëntokës së tij.

6. Protokoli për parandalimin e ndotjes së Detit Mesdhe nga lëvizja ndërkuftare e mbeturinave të rrezikshme dhe nga depozitimi i tyre.

Neni 2

Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit të derdhë kontributin financiar vjetor të Republikës së Shqipërisë, detyrim ky që i lind vendit tonë si palë në këtë konventë dhe në protokollet e saj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2815, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8692, datë 16.11.2000

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E BONIT “PËR
MBROJTJEN E LLOJEVE SHTEGTUESE TË KAFSHËVE TË EGRA”
DHE MIRËKUPTIMET E KËSAJ KONVENTE**

Në mbështetje të neneve 78, 81, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Bonit të datës 23.6.1979 “Për mbrojtjen e llojeve shtegtuese të kafshëve të egra” dhe mirëkuptimet e kësaj Konvente.

Neni 2

Autorizohet Këshilli i Ministrave për aderimin e Republikës së Shqipërisë në mirëkuptimet e mëpastajme në bazë të kësaj Konvente.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2816, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr.8697, datë 23.11.2000

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË GREKE PËR PROJEKTIN E
INFRASTRUKTURËS SOCIALE PËR SEKTORIN E ARSIMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Greke për projektin e infrastrukturës sociale për sektorin e arsimit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2822, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE HUADHËNËSE

MARRËVESHJE më datë 25.07.2000, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) të përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Qeveria e Republikës Greke (Huadhënësi), të përfaqësuar nga Zëvendës ministri i Ekonomisë Kombëtare.

Vërtetohet:

Ndërsa, në pajtim me Protokollin mbi Bashkëpunimin Ekonomik midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, të nënshkruar në Athinë më 9 shtator 1997 dhe Protokollit të Bashkëpunimit Ekonomik midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, të nënshkruar në Tiranë më 15 tetor 1997 (“Protokollet”) të cilat janë bashkëngjitur veç kësaj dhe përbëjnë një pjesë integrale të Marrëveshjes në fjalë si Eksponente A dhe B, Huadhënësi kishte rënë dakord të jepte një hua për një bilionë e pesëqind milionë dhrahmi greke (1 500 000 000 GRD) Huamarrësit për financimin e rindërtimit të shkollave ekzistuese dhe ndërtimit të shkollave të reja në kuadër të financimeve të Programeve të Infrastrukturës së Shkollave. (“Projekti”).

Ndërsa në bazë të Protokolleve, Huamarrësi ka kërkuar që Huadhënësi t’i japë një hua Huamarrësit të cilën Huadhënësi është i gatshëm ta kryejë mbi bazë të afateve dhe kushteve të mëposhtme,

Tani, si rrjedhim, duke marrë në konsideratë premiset dhe marrëveshjet e përfshira në këtë, është rënë dakord nëpërmjet saj për sa vijon:

Neni 1

Përkufizimet

Përveçse kur jepet ndryshe, termat me germa të mëdha të përdorura do të kenë kuptimet e specifikuar si më poshtë:

“Person i autorizuar” nënkupton në lidhje me huamarrësin, Ministrin e Financave të Shqipërisë.

“Ditë pune” nënkupton çdo ditë përveç të shtunës, të dielës ose të një dite në të cilën Bankat Tregtare janë të autorizuar të mbyllën sipas ligjit në Athinë.

“Periudha e Angazhimit” nënkupton periudhën nga data që të gjitha kushtet e kërkuara të ratifikimit të mëparshëm dhe procedurat në lidhje me efektivitetin e Marrëveshjes do të jenë plotësuar nga të dyja palët deri ditën kur mbushen tre vjet pas kësaj date (të dyja datat përfshihen).

“Këshilltar” do të nënkuptojë avokat ose këshilltar ligjor.

“Kontrata e ndërtimit” nënkupton kontratën ose kontratat që do të nënshkruhen midis Huamarrësit ose ndonjë personi tjetër të autorizuar ose njësi e Huamarrësit dhe tenderuesit ose tenderuesve që rrjedhin nga një prokurim ose prokurimet publike respektive për rehabilitimin e shkollave ekzistuese dhe ndërtimin e shkollave të reja.

“Disbursim” nënkupton çdo disbursim të huasë.

“Data e tërheqjes” nënkupton çdo ditë pune në të cilën një disbursim kryhet.

“Hipotekim” nënkupton çdo vënie peng, tarifë (nëse është fikse ose qarkulluese), paradhënie, kolateral, hipotekim, e drejtë, ndalime ose ndonjë interes ose marrëveshje siguracioni të çfarëdolloj dhe sidoqoftë e lidhur.

“Detyrim i Jashtëm” nënkupton detyrimet ekzistuese dhe në të ardhmen për paratë e huajtura nga ana e huamarrësit, siç të jenë rasti, të shprehur ose të pagueshme ose të mundshme për t’u paguar në çdo monedhë, përveçse monedhës legale të Huamarrësit (ku përfshihet çdo garanci e dhënë nga Huamarrësi).

“Rast mospagimi” ka kuptimin e atribuar në nenin 7 për këtë.

“Dokumente financiare” nënkuptojnë të marra së bashku, këtë Marrëveshje, Protokollet dhe Kontratën e Ndërtimit.

“Dhrahmia greke” dhe “GRD” nënkupton monedhën e ligjshme monetare për kohën në fjalë të Republikës Greke. Sipas shkallës së kërkuar dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të ligjit mbi paranë, Huaja, interesi mbi vlerën e Huasë dhe çdo borxhi të Huamarrësit ndaj huadhënësit e cila është e pagueshme në GRD, do të gjykohet, pa patur nevojë për ndonjë veprim të Huadhënësit apo të Huamarrësit, si të jetë emëruar në Monedhën e Vetme Europiane (EURO) në kohën që GRD do të shkrihet në EURO dhe/ose më në përgjithësi nga momenti që GRD do të zëvendësohet nga EURO, në përputhje me rregullat e aplikueshme të Bashkimit Europian dhe/ose në qoftë se kërkohet, sipas klauzolave të legjislacionit grek. Barazia dhe/ose afatet dhe llogaritjet e shkëmbimit të GRD me EURO do të përcaktohen sipas neni 109L të Traktatit të Bashkimit Europian, rregullat e Ligjit i cili do të dekretohet në zbatim të këtij Neni dhe praktikës ndërkombëtare bankare, dhe shpenzimet e shkëmbimit do të bien plotësisht mbi Huamarrësin.

“Data e Pagesës së Interesit” nënkupton ditën e punës e cila korrespondon gjashtë muaj pas datës së tërheqjes dhe pas një periudhe gjashtëmujore të njëpasnjëshme paskëtaj.

“Komiteti i përbashkët” nënkupton komitetin e ngritur për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të projekteve të financuara brenda kuadrit të huasë të dhënë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë nga Republika Greke në pajtim me Protokollet e sipërpërmendur.

“Marrëveshje huaje” nënkupton këtë Marrëveshje të Huamarrjes midis Huamarrësit dhe Huadhënësit.

“Hua” nënkupton shumën kapitale të secilës marrje hua (“Transh”) të huamarrësit si më poshtë ose (siç e kërkon konteksti) shumën kapitale nga ku herë pas here të papaguar (së bashku “Huatë”).

“Shkollë” nënkupton çdo institucion ku zhvillohet arsim tetëvjeçar dhe i mesëm përveç se ndonjë institucioni ku kryhet arsimimi i një niveli universitar.

“Komiteti Mbikqyrës” nënkupton një komitet të përbashkët të përbërë prej katër (4) anëtarësh të caktuar si më poshtë: dy (2) anëtarë të caktuar nga Huadhënësi dhe dy (2) anëtarë të caktuar nga Huamarrësi.

Referimi në dhe përkufizimi i ndonjë dokumenti (duke përfshirë këtë Marrëveshje) do të gjykohet si një referim ndaj këtij dokumenti sepse atij mund t’i bëhet një amendament ose të modifikohet herëpsherë.

Neni 2 Qëllimi i Huasë

Të ardhurat e Huasë do të përdoren ekskluzivisht për rindërtimin e shkollave ekzistuese dhe ndërtimin e shkollave të reja sipas një liste të miratuar nga Huadhënësi.

Huamarrësi merr përsipër të kontribuojë me sigurimin e tokës që kërkohet për ndërtimin e shkollave të reja.

Huamarrësi merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet në lidhje me të gjitha studimet, projektet e nevojshme dhe infrastrukturën.

Huamarrësi do të sigurojë kështu që Projektet do të restaurohen ose ndërtohen nga kompani ndërtimi të interesuar greke ose kompani ndërtimi shqiptaro-greke ose kompani ndërtimi shqiptare që përfaqësohen me njëqind për qind (100%) kapital shqiptar.

Vlera dhe Disbursimi

Të varura nga afatet dhe kushtet e vëna për këtë, Huadhënësi bie dakord t'i japë Huamarrësit deri në 1 500 000 GRD (një bilion e pesë qind milionë dhrahmi greke) për Projektin.

Pas plotësimit të kushteve përkatëse të nenit 4 Huadhënësi do të disbursojë Huanë duke kredituar një llogari në dhrahmi greke të specifikuar nga Huamarrësi në datën e tërheqjes. Huamarrësi do të kërkojë shumën e një Disbursimi e cila nuk do të jetë jo më pak se njëqind milion GRD duke i dhënë njoftim të shkruar, në formën e Eksponentit A, Huadhënësit, të paktën njëzet (20) ditë pune më përpara se Ditës së tërheqjes të kërkuar në këtë njoftim. Është rënë dakord që Huadhënësi mund të zbresë nga shuma e disbursimit në ditën e tërheqjes çdo shpenzim të përshkruar këtu më poshtë, të marrë nga Huadhënësi më parë se data e tërheqjes. Disbursimet në këtë Hua do të bëhen në zbatim me afatin e pagesave të përshkruara në Kontratën e Ndërtimit.

Interesi

Kursi i interesit të aplikueshëm për këtë Hua do të jetë (5% në vit). Periudha e parë e interesit respektivisht për secilin Transh (jo vetëm për Transhin e parë) do të mbarojë në ditën e fundit të periudhës së Interesit respektivisht të Transhit të parë e cila është vazhduese në ditën në të cilën Transhi vijues do të tërhiqet nga ku Transhi i parë dhe secili Transh vijues do të konsolidohet dhe do të trajtohet si një Transh i vetëm me qëllim për Periudhat vijuese të Interesit. Interesi mbi vlerën e Transhit do të jetë i përcaktuar dhe i pagueshëm në gjysma-vjetore në borxhe sipas secilës Datë të Pagesës së Interesit.

Nëse Huamarrësi do të mospaguajë ndonjë pagesë interesi ose kapitali në ditën e caktuar, Huamarrësi do të jetë në mospagim meqenëse i ka kaluar afati i datës pa bërë njoftimin për këtë zgjatje dhe do të jetë i detyruar të paguajë interes për këtë shumë të papaguar (në vend të shkallës së interesit të referuar më sipër) në shkallën e (6%) në vit në ditën e fundit të secilit muaj që pason këtë datë të caktuar deri në datën kur shuma e papaguar të paguhet e plotë.

Raporti i kursit të shkëmbimit të interesit të huasë me shkallën e interesit vjetor në GRD e ofruar nga Qeveria Greke në ditën e nënshkrimit të Marrëveshjes, do të jetë e njëjtë me raportin e interesit vjetor në EURO në ditën e zëvendësimit të GRD me EURO.

Kthimi i Huasë

Huamarrësi do t'i kthejë huanë të plotë (37) këste gjysëm-vjetore. Kësti i parë i kësaj kthim pagese do të paguhet në ditën që mbushen (84) muaj pas datës së marrjes së parë hua dhe këstet vijuese të shlyerjes do të kthehen në intervale gjashtëmujore me një këst pagese përfundimtar në përvjetorin e njëzet e një të ditës së marrjes së parë hua sipas kësaj.

Parapagimi Vullnetar

Huamarrësi mund të parapaguajë çdo pjesë ose shumën totale të huasë në çdo kohë.

Taksat

Secila dhe të gjitha taksat që tani ekzistojnë ose mund të taksohen në të ardhmen mbi interesin dhe/ose në lidhje me kryerjen, regjistrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshje, dhe/ose në lidhje me çdo interes sigurimi në lidhje me Huanë, çdo taksë pulle dhe kosto dhe shpenzime të tjera të bëra në lidhje

me ekzekutimin, regjistrimin, protokollimin, menaxhimin dhe kryerjen e shërbimeve të Marrëveshjes së Huasë do të paguhet ekskluzivisht nga Huamarrësi.

Kështu të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi këtej e tutje, nëse është ajo e kapitalit, interesit, tarifave, shpenzimeve ose të tjera do të paguhet të plotë, të lira nga çdo zbritje ose mbajtje për secilën dhe të gjitha taksat, tatimet, taksa pulle, tarifatat, zbritjet, shpenzimet, ndalesat të vëna dhe që do të vihen dhe të gjitha detyrimet në lidhje me sa u përmendën deri tani (këtu së bashku do të referohen si “Taksa”).

Në qoftë se ndonjë zbritje ose ndalesë do të taksohet Huamarrësi do të paguajë çdo shumë shtesë që është e nevojshme për të siguruar që shuma neto aktualisht e marrë nga Huadhënësi do të barazohet me shumën e plotë që Huadhënësi do të kishte marrë nëse zbritja ose ndalesa të tilla nuk do të ishin kërkuar.

Huadhënësi do të njoftojë huadhënësin për çdo pagesë taksash të bëra nga Huadhënësi, dhe Huamarrësi do të paguajë ose rimbursojë Huadhënësin brenda 30 ditëve. Llogaritjet e Huadhënësit në mirëbesim të shumës së detyruar nga Huamarrësi në pajtim me vendimin pararendës do të plotësohen nga Huamarrësi në detaje të mjaftueshme dhe do të jenë përfundimtare dhe detyruese për Huadhënësin.

Rimbursimi i Shpenzimeve.

i) Huamarrësi do të paguajë ose do të rimbursojë Huadhënësin, sipas kërkesës, për shpenzimet dhe kostot e Huadhënësit jo të xhepit të kryera në lidhje me ekzekutimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe dokumentet e tjera financuese përfshirë pa kufizim, autentifikimin, regjistrimin dhe protokollimin e çdo Dokumenti Financiar. Huamarrësi do të ndajë barabar me Huadhënësin sipas kërkesës për të gjitha harxhet dhe shpenzimet (përfshirë pa kufizim, tarifatat dhe shpenzimet e arsyeshme për avokatin) të kryera nga Huadhënësi në mbajtjen në fuqi dhe veprim të plotë ose në zbatimin e të drejtave për këtë ose të çdo Dokumenti Financiar ose të kryer në lidhje me modifikimin, amendamentin ose heqjen e ndonjë klauzole tek një dokument i tillë.

ii) Për të gjitha shpenzimet e ndryshme për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Projektit si dhe të shpërbllimit të anëtarëve të komitetit të përbashkët dhe Komitetit të Mbikëqyrjes do të bihet dakord me anë të një Letre Dytësore dhe mund të mbulohen nga produkti i Huasë.

Monedha Monetare dhe Vendi i Pagesës

Të gjitha pagesat e kërkuara deri tani do të bëhen në Drahmi Greke në fonde të vlefshme të menjëhershme pa zbritje për taksat ose ndonjë tjetër, në Llogarinë Monetare të Shtetit Grek numër 200 në Bankën e Greqisë. Në qoftë se ndonjë ditë pagese nuk bie ditë pune, pagesa do të bëhet në ditën tjetër pasardhëse të Punës.

Llogaritja e Interesit mbi Huanë

Përveç se kur jepet ndryshe këtu interesi do të llogaritet mbi bazë të traditës së numërimit 360 ditë dhe numrit të ditëve aktuale që ka kaluar afati.

Aplikimi i Pagesave ndaj Huadhënësit

Pagesat e marra nga Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të aplikohen për pagimin së pari të Taksave nëse ka dhe Rimbursimit të Shpenzimeve për këtë nëse ka, së dyti, çdo interes të papaguar ose të kaluar afati, së treti, çdo interes që është në afat, së katërti, kapitali sipas afatit, dhe së pesti çdo parapagim vullnetar.

Neni 3

Përfaqësimet dhe Garancitë

Huamarrësi përfaqëson, lidh kontratë, garanton Huadhënësin se:

Ekzistenca e fuqisë së Huamarrësit

Huamarrësi ka fuqinë të marrë hua dhe të krijojë një të ardhur nga pasuritë e tij dhe të hartojë dhe të kryejë secilin nga Dokumentet Financiar tek të cilat ai është ose do të jetë palë.

Autorizimi i Huamarrësit

Ekzekutimi, lëvrimi dhe zbatimi i Huamarrësit të secilit Dokument Financiar tek të cilët ai është ose do të jetë palë; (i) është autorizuar siç duhet me të gjitha veprimet e nevojshme; (ii) nuk do të thyejë asnjë rregullore të aplikueshme ose rregull të çdo autoriteti qeveritar. Dhe (iii) nuk do të shkelë ose të shkaktojë taksimin e ndonjë hipoteke mbi ndonjë nga asetet e tij sipas, ndonjë marrëveshje ose kërkesë tjetër për të cilën ndonjë nga pasuritë e tij mund të kufizohet ose ndikohet. Ekzekutimi dhe lëvrimi nga ana e Huamarrësit për secilin Dokument Financiar në të cilin ai është ose do të jetë palë do të shkaktojë që secili instrument përkatës të formojë një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit të hyrë në fuqi në përputhje me kushtet e saj. Detyrimi i Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshje dhe Protokollit është detyrimi i tij i drejtpërdrejtë, pa kushte dhe i përgjithshëm dhe rradhitet të paktën Pari Passu me të gjitha detyrimet e tij të tanishme dhe të ardhshme, të pasiguruara dhe të pavarura.

Obligacionet

Huamarrësi nuk ka mospagime, as nuk është i lidhur kontraktualisht për të krijuar ndonjë lënie peng, garanci, hipotekim ose ndonjë lloji tjetër interesi siguricioni mbi ose në lidhje me ndonjë nga pasuritë, të ardhurat ose asetet e tij ekzistuese ose në të ardhmen, për të siguruar ndonjë nga detyrimet debitorë.

Mospagesat

Huamarrësi nuk është në shkelje të ndonjë klauzole të një kontrate në të cilën Huamarrësi është palë e cila do të ketë një efekt qenësisht të pafavorshëm mbi situatën ose aftësinë financiare të Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë Dokumenti tjetër Financiar. Asnjë rast s'mund të ndodhë që të shkaktojë një mospagesë sipas ose në lidhje me ndonjë marrëveshje ose dokumenti në të cilën Huamarrësi është palë ose nga e cila Huamarrësi mund të jetë i lidhur ose asnjë mospagim nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon të jetë i parrregulluar, ose nuk do të rezultojë nga marrja e Huasë (ose të ndonjë pjese nga kjo) ose kryerja nga ana e Huamarrësit e detyrimeve të tij sipas Dokumenteve Financiare.

Gjyqësori

Asnjë veprim, padi, procedurë gjyqësore ose shkelje gjyqësore nuk është i pazgjidhur nga ose para Gjykatës vendore ose të huaj ose një autoriteti qeveritar ose, në dijeni të Huamarrësit pasi një hetim i detyrueshëm kërcënohet ndaj Huamarrësit ose ndonjë prej pasurive ose të drejtave të tij që, nëse vendoset ndryshe, ka të ngjarë të ndikojë qenësisht në mënyrë të pafavorshme në situatën e tij financiare ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij në bazë të kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë tjetër Dokumenti Financiar.

Pajtueshmëria me Ligjin

Huamarrësi duhet të ketë marrë në kohën e duhur të gjitha miratimet, aprovimet dhe autorizimet kryesore dhe të ketë përmbushur të gjitha deklaratat, dosjet dhe regjistrimet e nevojshme për ekzekutimin, lëvrimin dhe kryerjen e duhur nga ana e Huamarrësit për secilën nga Dokumentet Financiare, në të cilat ai është ose duhet të bëhet palë, përveç atyre që lidhen me veprimet dhe transaksionet e ardhshme të cilat priten të përftohen natyrshëm dhe atyre që i referohen Aprovimeve të Qeverisë për këtë.

Hapja

Të gjitha dokumentet, raportet ose informacione të tjera me shkrim që kanë të bëjnë me Projektin (duke përfshirë pa kufizim këtë marrëveshje) me të cilat është pajisur edhe Huadhënësi janë të vërteta dhe të sakta dhe nuk përmbajnë asnjë thënie të gabuar të fakteve ose lënie jashtë të thënieve të një fakti thelbësor ose të çdo fakti i cili do t'i kthejë këto thënie që përfshihen këtu ose prej këtej në çorientuese.

Neni 4

Kushtet precedente për Disbursimin

Vetëm nëse Huadhënësi bie dakord ndryshe me shkrim, obligimi i Huadhënësit për të bërë

Disbursimet e Huasë do t'i nënshtrohet plotësisht prioritar të satisfaksionit të Huadhënësit në mirëbesim të plotë për kushtet e mëposhtme precedente dhe plotësisht të tyre të vazhdueshëm në çdo Ditë Tërheqjeje.

Autorizimet

Huadhënësi do të ketë marrë, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme me të, si më poshtë:

Një kopje të të gjitha dokumenteve ratifikues të kësaj Marrëveshje, siç kërkohet nga Kushtetuta dhe Ligjet e Huamarrësit, të vërtetuara si të qenurit kopje e vërtetë nga Nëpunësi i Autorizuar i Huamarrësit; dhe

Një kopje e Vendimit të Qeverisë Shqiptare, që aprovon këtë Marrëveshje dhe autorizon një person ose persona të specifikuar për të ekzekutuar këtë Marrëveshje në emër të Qeverisë së Huamarrësit, të vërtetuar si të qenurit kopje e vërtetë nga Nëpunësi i Autorizuar i Huamarrësit.

Një vërtetim nga Nëpunësi i Autorizuar, që vërteton emrat, postet, dhe nënshkrimet e njohura të personave të cilët janë autorizuar të ekzekutojnë dhe të lëvrojnë në emër të Huamarrësit në aftësitë e tij si përfaqësues të Huamarrësit këtu, këtë Marrëveshje dhe shkresat e tjera apo instrumente që do bëhen që këtu.

Miratimet e Qeverisë

Huadhënësi duhet të ketë marrë kopjet e vërtetuara nga Nëpunësi i Autorizuar i Huamarrësit si kopje të vërteta dhe në fuqi të plotë verpimi të ndonjë ratifikimi, regjistrimi, pëlqimi i Qeverisë ose aprovimi i kërkuar ose i marrë në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjet e Huamarrësit ose të nevojshme për Protokoll, kjo Marrëveshje, Huaja, dhe pagesa e të gjitha shumave të caktuara ose që do të caktohen në lidhje përveç kësaj që s'i janë nënshtruar ndonjë Takse.

Mendimet ligjore

Huadhënësi duhet të ketë marrë mendimet me shkrim të datuara me datën e ditës së tërheqjes, secila prej tyre do të jetë në formë dhe përmbajtje e kënaqshme për Huadhënësin, (i) ose të avokatit special ligjor të tij në Tiranë dhe (ii) avokatit ligjor të Huamarrësit.

Marrëveshja e Ndërtimit

Huadhënësi duhet të ketë marrë kopjet e vërtetuara nga Nëpunësi i Autorizuar i Huamarrësit për Marrëveshjen e Ndërtimit.

Përfaqësimet dhe Garancitë

Përfaqësimet dhe garancitë të parashtruara në nenin 3 për këtë, do të jenë të vërteta dhe të sakta në datën e Disbursimit, sikur të jenë bërë në këtë datë, dhe në këtë datë asnjë rast mospagimi (si në të ardhmen e përcaktuar), dhe asnjë rast apo kusht me të cilin kalimi i afatit ose i dhënies së njoftimit, ose të dyja do të përbëjnë një rast të mospagesës, që do të ekzistojë.

Ndryshim i Rrethanave

Në kohën e Disbursimit, asnjë rrethanë ose ndryshim të ligjit ose të rregullores të ndonjë autoriteti qeveritar s'do ketë ndodhur e cila sipas gjykimit të shëndoshë të Huadhënësit do të ndikojë qenësisht në mënyrë të pafavorshme, situatën financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij që këtu.

Vërtetimi

Huamarrësi duhet të ketë pajisur Huadhënësin me një vërtetim, në formë dhe përmbajtje të plotë për Huadhënësin, të nënshkruar nga Nëpunësi i Autorizuar i Huamarrësit që vërteton plotësimin e secilit nga kushtet e parashtruara në Përfaqësimet dhe Garancitë për këtë efektive, si dhe të datës së kërkuar të këtij Disbursimi dhe të vërtetojë që të ardhurat e Disbursimit nevojiten për qëllimet e Projektit.

Neni 5

Kontrata miratuese

Vetëm nëse Huadhënësi bie dakord ndryshe me shkrim, për aq kohë sa Angazhimi do të mbetet i papaguar dhe derisa pagesa e plotë për të gjitha shumat e caktuara dhe që do të caktohen, Huamarrësi

lidh kontratë dhe bie dakord si më poshtë:

Detyrimet e Huamarrësit

Huamarrësi do të kryejë të gjitha obligimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe çdo Dokumenti tjetër Financiar në të cilin ai është palë.

Njoftimi i Mospagesës dhe Çështje të Tjera

Huamarrësi duhet të njoftojë menjëherë Huadhënësin (i) për rastisjen e çdo ngjarjeje Mospagimi dhe për secilin rast të njohur nga ndonjë prej nëpunësve të tij të cilat me dhënien e njoftimit, kalimin e afatit ose të dyja, do të bëhet një Rast i Mospagesës, dhe (ii) rastisja e ndonjë kushti tjetër ose ngjarjeje (duke përfshirë veprimin shtetëror) i cili ka të ngjarë të ndikojë qenësisht në mënyrë të pavaroshme mbi situatën financiare të Huamarrësit ose aftësisë së tij për të përmbushur detyrimet e tij sipas ndonjë Dokumenti Financiar.

Neni 6

Kontrata Negative

Vetëm nëse Huadhënësi bie dakord ndryshe me shkrim, për aq kohë sa Angazhimi do të mbetet i papaguar dhe derisa pagesa e plotë për të gjitha shumat e caktuara dhe që do të caktohen, Huamarrësi lidh kontratë dhe bie dakord si më poshtë:

Asnjë Ndryshim të Marrëveshjeve

Huamarrësi nuk do të përfundojë, bëjë amendament ose të bëjë ndonjë dorëheqje, ose të caktojë ndonjë nga detyrat dhe obligimet e tij sipas, ndonjë klauzole të çdo Dokumenti Financiar në të cilin ai është palë (ose amendamente ose dorëheqje për të rregulluar gabime të dukshme ose të cilat janë formale, të vogla dhe të një natyre teknike dhe nuk ndryshojnë qenësisht ndonjë të drejtë ose obligim të ndonjë pale).

Drejtimi i zakonshëm i Biznesit

Huamarrësi nuk do të:

ndryshojë qenësisht natyrën ose qëllimin e Projektit;

ndryshojë ligjin e tij në mënyrë që ai të bëhet i papajtueshëm me kushtet e ndonjë nga Dokumentet Financiare.

Neni 7

Mospagesat dhe mjetet

Rasti i Mospagesave

Ndodhja dhe vazhdimësia e ndonjë nga rastet ose rrethanat e mëposhtme do të përbëjë një “Rast të Mospagesës” si këtu;

Huamarrësi dështon të paguajë puntualisht kur është e detyrueshme ndonjë interes ose principal ose ndonjë shumë tjetër të pagueshme në pajtim me këtë Marrëveshje; ose

Huamarrësi dështon të paguajë kur është e detyrueshme ndonjë interes ose principal mbi ndonjë nga Detyrimet e tij të jashtme debitore dhe ky lloj dështimi do të vazhdojë pas periudhës së mirëbsimit, nëse ka, të aplikueshme përveç kësaj, ose një mospagim ndodh sipas ndonjë marrëveshjeje apo instrumenti të dëshmuar ose sipas të cilit Huamarrësi ka të papaguar në kohën që ky Detyrim i Huaj debitor dhe ky lloj mospagimi do të vazhdojnë përtej kohës së mirëbesimit, nëse ka, të aplikueshme përveç kësaj, nëse efekti i këtij mospagimi është për të përshpejtuar ose për të lejuar që maturimi i këtij Detyrimi të Huaj; ose

Ndonjë përfaqësim ose garanci e bërë nga ose në emër të Huamarrësit në këtë Marrëveshje, ose në ndonjë njoftim ose vërtetim tjetër, dokument ose financë ose citim i shpërndarë në pajtim për më tepër do të provojë të ketë qenë jo i saktë në çdo lidhje materiale ku bëhet; ose

Huamarrësi dështon të veproj në përputhje me ndonjë kontratë ose klauzolë të parashtruar për

këtë; ose

Ndonjë ratifikim, autorizim, pëlqim ose miratim të ndonjë agjencie qeveritare ose autoritet publik i nevojshëm për ekzekutimin, lëvrimin ose kryerjen e kësaj Marrëveshjeje, ose të ndonjë Dokumenti tjetër Financiar ose për vlefshmërinë ose detyrueshmërinë e ndonjë të obligimeve të Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje, ose Dokumenti tjetër Financiar, nuk do të bëjë ose japë ose do të bëjë të tërhiqet ose të pushojë të mbetet në fuqi të plotë dhe zbatim; ose

Kjo Marrëveshje, për ndonjë arsye pushon të jetë në fuqi dhe zbatim të plotë ose deklarohet të jetë e pavlefshme ose refuzohet ose vlefshmëria ose detyrimi për këtë ose nga ku është në çdo kohë e kontestuar nga Huamarrësi; ose

Të gjitha ose një pjesë thelbësore e aseteve të Huamarrësit do të shpronësohen nga ndonjë autoritet ose Huamarrësi do të transferojë ose të sistemojë të gjitha ose një pjesë thelbësore të aseteve të tij.

Një autorizim ligjor për shtyrje pagese deklarohet për pagesën e ndonjë Detyrimi të Jashtëm debitor për paratë e huajtura të Huamarrësit.

Çdo Detyrim i Jashtëm debitor i Huamarrësit (i) që s'është paguar në datën e detyrueshme ose brenda periudhës së mirëbesimit të specifikuar në marrëveshjen përkatëse (ii) bëhet i detyrueshëm dhe i pagueshëm përpara maturitetit të tij normal për arsye të një mospagimi ose rast të vonesës së mospagimit si është e përshkruar, sipas ndonjë marrëveshjeje në të cilën Huamarrësi është një palë.

Mjetet mbi Rastin e Mospagimit

Në qoftë se ndonjë Rast Mospagimi ka ndodhur dhe vazhdon, Huadhënësi mundet në çdo kohë me liri të plotë veprimi, (i) të pezullojë ose t'i japë fund Angazhimit, (ii) të deklarojë, me kërkesë me shkrim për pagesën ndaj Huamarrësit, çdo pjesë ose të gjithë shumën e principalit të papaguar të Huasë të jetë e detyrueshme dhe e pagueshme ku kjo pjesë e Huasë do të maturohet menjëherë dhe të bëhet e detyrueshme dhe e pagueshme së bashku me interesin të kryer si pasojë, pa ndonjë deklaratë tjetër gjyqësore, kërkesë, zelli, protestë, njoftim të përshpejtimit, ose të ndonjë njoftimi të çdo lloji, për të gjitha të cilat Huamarrësi për këtë jep dorëheqje dhe/ose (iii) pa njoftim të mospagesës ose kërkesë, procedon për të mbrojtur dhe detyruar të drejtat e tij dhe mjetet me anë të procedurave të përshtatshme, nëse për dëmet ose kryerjen specifike të ndonjë kushti të kësaj Marrëveshjeje ose në ndihmë të ushtrimit të ndonjë force të dhënë në këtë Marrëveshje, ose nga Ligji.

Juridiksioni dhe Kërkesa për Padi

Palët për më tepër përfundimisht bien dakord që Gjykatat e Republikës Greke do të kenë juridiksionin për të dëgjuar dhe vendosur çdo padi, veprim ose procedurë dhe për të zgjidhur ndonjë konflikt, i cili mund të ngrihet nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe për këto qëllime përfundimisht i nënshtrohet këtyre gjykatave.

Huamarrësi për këtë përfundimisht tërheq çdo objeksion prezent ose në të ardhmen për këtë vendtakim, dhe përfundimisht jep pëlqimin dhe i nënshtrohet pa kushte juridiksionit non-ekskluzive për vetë dhe në lidhje me ndonjë nga pasuritë e tij të ndonjë gjykate të tillë. Huamarrësi më tej tërheq përfundimisht çdo ankim se ndonjë gjykatë e tillë nuk është një forum i përshtatshëm për procedura të tilla. Huamarrësi bie dakord që çdo shërbim të procesit, urdhërave gjyqësore, gjykimi ose njoftimi tjetër të procesit ligjor do të shqyrtohet dhe mbahet në çdo aspekt për t'u shërbyer efektivisht për të. Asgjë s'do të ndikojë këtu në të drejtën e Huamarrësit ose të Huadhënësit për të kryer procesin në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar nga ligji i aplikueshëm. Huamarrësi më tej bie dakord që gjykimi final kundër asaj në këtë veprim ose procedure që rrjedh ose lidhet me këtë marrëveshjeje, do të jetë vendimtar dhe do të jetë i detyrueshëm dhe do të ekzekutohet kundrejt Huamarrësit dhe aseteve dhe pasurive të tij të vendosura brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me kërkesë padi për gjykim, një kopje e vërtetuar e cila do të jetë dëshmi vendimtare e faktit dhe e shumës së detyrimit debitor.

Neni 8
Të ndryshme

Njoftime

Çdo raport, njoftim dhe komunikim tjetër që do të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje duhet të jetë me shkrim në gjuhën angleze, të dorëzohet dorazi, me postë, telegram ose teleks, tarifa postare e parapaguar, dhe të gjykohet se është dhënë ashtu siç duhet kur të merret në adresat e mëposhtme:

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave

Departamenti i Borxhit të Jashtëm dhe Financës Ndërkombëtare

Bulevardi Dëshmorët e Kombit nr.1

Tirana, Shqipëri

Telefon/Faks: (355 42) 29 200

Për Huadhënësin:

Ministria e Ekonomisë Kombëtare

Sekretariati i Përgjithshëm për Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare

Drejtoria e Europës Qendrore dhe Lindore

I. Cornarou Str.

II. Gr – 10180 Athinë

Telefon: (01) 328 62 01/328 62 48

Faks: (01) 328 62 09

Çdo palë mund të ndryshojë duke bërë njoftim me shkrim për të tjerët se ku duhet të dërgohen komunikimet.

Mbikëqyrja

Zhvillimi i rindërtimit dhe ndërtimit të shkollave do të drejtohet nga Komiteti Mbikëqyrës, i cili do të dërgojë të gjitha raportet te Komiteti i Përbashkët për zbatimin e Protokollit. Hollësitë në lidhje me themelimin e funksionet e Komitetit Mbikëqyrës do të përcaktohen në një etapë të mëvonshme.

Ligji drejtues. Titujt Përshkrues

Kjo Marrëveshje do të drejtohet e interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës Greke. Titujt në këtë Marrëveshje janë vënë me qëllim referimi dhe nuk kufizojnë ose prekin kuptimin e saj.

Përfaqësuesi i procesit

Huamarrësi emëron për këtë Ambasadorin e Huamarrësit në Athinë për të vepruar në liri të plotë veprimi te Huadhënësit si përfaqësuesi dhe prokurori i tij të cilit Huadhënësi mund t'i njoftojë çdo dokument, teleks apo telegraf dhe për më tepër çdo dokument ligjor të lidhur drejtpërdrejt ose indirekt me këtë Marrëveshje ose dokument tjetër.

Vazhdimësia (e drejta e trashëgimisë)

Kjo Marrëveshje do të ambientohet në dobi dhe do të jetë detyruese mbi pasardhësit dhe përfaqësuesit e emëruar të palëve për më tepër, me kusht që Huamarrësi, pa miratimin me shkrim më parë të Huadhënësit, nuk do të emërojë ose delegojë të gjitha ose një pjesë të interesit ose të obligacioneve të tij prej këndeje.

Kohëzgjatja e Marrëveshjes (Mbijetesa)

Secila prej Marrëveshjeve, përfaqësimeve dhe garancive që përfshihen ose i referohen kësaj Marrëveshjeje do t'i mbijetojnë çdo hetimi në çdo kohë që të bëhet nga Huadhënësi dhe disbursimi i Huasë, përveç për shpenzimet e lejuara për këtë dhe do të përfundojë vetëm kur të gjitha vlerat e

caktuara ose që do të përcaktohen sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhen të plota.

Integrimi, Amendamentet

Kjo Marrëveshje mishëron mirëkuptimin e plotë të palëve për më tepër, dhe zëvendëson të gjitha negociatat, mirëkuptimet dhe marrëveshjet e mëparshme ndërmjet tyre në lidhje me çështjen në fjalë për këtë. Klauzolat e kësaj Marrëveshjeje mund të hiqen ose të plotësohen ose të bëhen amendamente vetëm me një instrument me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar në mënyrën e duhur nga Huamarrësi dhe Huadhënësi.

Asnjë dorëheqje

Asnjë zhvillim në marrëdhëniet tregtare dhe asnjë dështim ose vonesë nga ana e huadhënësit në ushtrimin e së drejtës, së fuqisë ose të mjetit në këtë s'do të veprojë si një dorëheqje nga ku ose ndryshe paragjykohe të drejtat e fuqitë e mjetet e Huadhënësit. Asnjë e drejtë, fuqi dhe mjet i akorduar Huadhënësit për këtë nuk do të mbizotërojë mbi ndonjë të drejtë, fuqi, mjet tjetër të referuar për këtë ose nga ku ose tani dhe në të ardhmen e vlefshme sipas ligjit, në barazi dhe me statut ose ndryshe.

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të tij përfundimtar nga Parlamenti Shqiptar dhe pas ratifikimit nga Parlamenti Grek të Protokollit.

Në prani të nga ku, secila nga palët për më tepër kanë bërë që kjo Marrëveshje të ekzekutohet dhe të shpërndahet në dy kopje në gjuhën angleze në emër të përfaqësuesve të tyre të autorizuar në datën e sipërsënuar.

PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS GREKE

Yannis Zafeiropoulos
Zv.Ministër i Ekonomisë Kombëtare

PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Anastas Angjeli
Ministër i Financave

EKSPONENTI A

Merr: Ministria e Ekonomisë Kombëtare
Athinë

Data

Në pajtim me nenin 1 të Marrëveshjes së Huamarrjes më datë 1998 ("Marrëveshja e Huasë") midis nesh si Huamarrës dhe jush si Huadhënës, në lidhje me Huanë e GRD 1.500.000.000 në për këtë ju japim njoftimin e marrjes hua të propozuar si më poshtë:

- (a) Data
- (b) Shuma
- (c) Udhëzimet e Pagesës

Ne konfirmojmë se Përfaqësuesit dhe Garancitë e përcaktuara në nenin II3 të Marrëveshjes së Huasë janë të vërteta dhe të sakta në datën prej saj se ajo është bërë në këtë datë dhe asnjë Mospagim (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë) nuk do të ndodhë dhe nuk do të vazhdojë ose do të shkaktohet nga marrja hua e propozuar.

**AMENDAMENT PËR MARRËVESHJEN E HUASË TË PARASHIKUAR NË KUADRIN E
PROTOKOLLEVE MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK TË NËNSHKRUAR MIDIS QEVERISË
SË REPUBLIKËS GREKE DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË**

Qeveria e Republikës Greke dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë bien dakord që të gjitha shpenzimet e ndryshme për bashkëpunimin dhe monitorimin e të Projekteve të financuara brenda kuadrit të huave të dhëna Qeverisë së Republikës të Shqipërisë nga Qeveria e Republikës Greke në pajtim me Protokollet mbi Kooperimin Ekonomik, si dhe të shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Përbashkët dhe Komitetit të Mbikëqyrjes do të përcaktohen në një letër të veçantë dhe mund të mbulohen nga produkti i Huasë.

**PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS GREKE**
Yannis Zafeiropoulos
Zv.Ministër i Ekonomisë Kombëtare

**PËR QEVERINË
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
Anastas Angjeli
Ministër i Financave

L I G J
Nr.8698, datë 23.11.2000

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET QEVERISË SË
REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË GREKE PËR PROJEKTIN E
INFRASTRUKTURËS SOCIALE PËR SEKTORIN E SHËNDETËSISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë Greke për projektin e infrastrukturës sociale për sektorin e shëndetësisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2823, datë 5.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJE HUAJE

Marrëveshje e lidhur më datë 25.6.2000, mes Qeverisë së Republikës të Shqipërisë (“Huamarrësi”) e përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Qeverisë së Republikës Helene (“Huadhënësi”) e përfaqësuar nga Zëvendësministri i Ekonomisë Kombëtare

Janë dëshmitarë të:

E konsideruar në mbështetje të Protokollit mbi Bashkëpunimin Ekonomik mes Qeverisë së Republikës Helene dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, nënshkruar në Athinë më 9 shtator 1997 dhe në Protokollin mbi Bashkëpunimin Ekonomik të nënshkruar në Tiranë më 15 Tetor 1997 (“Protokolli”) të cilat gjenden bashkëngjitur dhe që quhen pjesë përbërëse e Marrëveshjes aktuale sipas Pasqyrave A dhe B, Huadhënësi ka rënë dakord të japë një hua prej një miliard e pesëqind milionë Drahmi Greke (GRD 1.500.000.000) Huamarrësit për financimin e blerjes së pajisjeve për një Klinikë Materniteti ekzistuese në kuadrin e financimit të Programeve të Infrastrukturës Sociale, (“Projekti”)

E konsideruar në bazë të Protokollit, Huamarrësi, ka kërkuar që Huadhënësi t’i japë një hua Huamarrësit, gjë të cilën, Huadhënësi, dëshiron ta bëjë në termat dhe kushtet e dhëna këtu,

Tani, si rrjedhim duke konsideruar premisat dhe të marrëveshjeve që përmbahen këtu, është rënë dakord si vijon:

Neni 1

(Definicione) Përcaktime

Përveçse, në rastet e parashikuar ndryshe termat e kapitalizuara të përdorura këtu do të kenë kuptimet e specifikuar më poshtë:

“Zyrtar i Autorizuar” do të thotë duke respektuar Huamarrësin, Ministrin e Financave të Shqipërisë.

“Ditë Pune” do të thotë çdo ditë përveçse e Shtuna dhe e Diela ose ditët, në të cilat bankat tregtare, në Athinë, janë të autorizuara me ligj të mbyllën.

“Periudha e Angazhimit” do të thotë periudha nga data kur të gjitha kushtet e kërkuara në ratifikimin e mëparshëm dhe procedurat për respektimin e efektivitetit të marrëveshjes do të jenë kompletuar nga të dyja palët deri në ditën që i bie tre (30 vjet pas kësaj date (të dy datat janë të përfshira në Periudhë).

“Këshilltar” do të thotë noter ose një këshillues ligjor.

“Disbursim” do të thotë çdo disbursim i Huasë.

“Data e Tërheqjes” do të thotë çdo ditë pune në të cilën disbursimi është kryer.

“Barra” do të thotë borxhi, pagesa (fikse ose e lëvizshme) premtimi për të paguar, e drejta mbi pronën, hipotekimi, barra, titulli financiar, garancia ose marrëveshje sigurie ose interesi të çfardolloji dhe të nisura në çdo lloj mënyre.

“Borxhe të Jashtme” do të thotë borxhe ekzistuese dhe të ardhshme për para të huajtura nga Huamarrësi siç mund të jetë rasti, i shprehur i pagueshëm ose opsionalisht i pagueshëm në ndonjë monedhë, përveçse monedha ligjore e Huamarrësit (përfshirë ndonjë garanci të dhënë nga Huamarrësi).

“Ngjarja e Dështimit” ka kuptimin e atribuar asaj në nenin 7 më poshtë.

“Dokumentet e financimit” do të thotë kolektivisht, kjo Marrëveshje, Protokollat dhe Kontrata e Blerjes.

“Drahmi Greke” dhe “GRD”, do të thotë monedha e ligjshme për kohën në Republikën Helene. Në shtesën e kërkuar dhe në përputhje me principet kryesore të Ligjit të parasë, Huaja, interesi mbi shumën e Huasë dhe ndonjë borxh tjetër i Huamarrësit ndaj Huadhënësit, i cili është i pagueshëm në Drahmi Greke, do të prezumohet, pa pasur nevojë për ndonjë veprim nga Huamarrësi ose Huadhënësi siç është përcaktuar në Monedhën e Vetme Europiane (EURO) në kohën kur GRD

(Dhrahmia Greke) do të përfshihet në EURO dhe/ose më përgjithësisht nga momenti që GRD do të zëvendësohet nga EURO, në përputhje me rregullat e aplikueshme në Bashkimin Europian dhe/ose nëse kërkohet, sipas parashikimeve të legjislacionit grek. Pariteti dhe/ose termat dhe përlllogaritjet e këmbimit të GRD në EURO do të vendosen sipas nenit 109L të Traktatit të Bashkimit Europian, rregullave të Ligjit që do të hyjë në fuqi në aplikimin e këtij neni dhe praktikave bankare ndërkombëtare dhe shpenzimet e këmbimit do të përballohen tërësisht nga Huamarrësi.

“Data e Pagesës së Interesit”, do të thotë një ditë pune e cila përkon me gjashtë muaj nga data e tërheqjes dhe pas çdo periudhe gjashtë mujore të mëpasme.

“Komiteti i Përbashkët” do të thotë komiteti i themeluar për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të projekteve të financuara brenda kuadrit të huasë së dhënë Qeverisë së Republikës të Shqipërisë nga Qeveria e Republikës Helene në pajtim me Protokollin e sipërpërmendura.

“Marrëveshje Huaje” do të thotë kjo marrëveshje Huaje mes Huamarrësit dhe Huadhënësit.

“Hua” do të thotë shuma kryesore (principali) e çdo “transhi” të huajtur të Huamarrësit si më tej ose (siç e kërkon kuptimi) shuma kryesore e cila nga koha në kohë qëndron e veçantë (kolektivisht “Huat”).

“Kontratë Blerjeje” do të thotë kontrata mes Republikës së Shqipërisë dhe Shitësit os ndërmjetësit për pajisjet.

“Komiteti i Vëzhgimit” do të thotë një komitet i përbashkët i cili konsiston në katër(4) anëtarë të caktuar si vijon: dy(2) anëtarë të emëruar nga Huadhënësi dhe dy(2) anëtarë të emëruar nga Huamarrësi.

Referenca tek dhe përcaktimi i ndonjë dokumenti (përfshirë këtë Marrëveshje) do të quhet si një referencë ndaj një dokumenti të tillë, për sa ai mund të amendohet ose modifikohet nga koha në kohë.

Neni 2 Qëllimi i Huasë

Procedurat e Huasë do të përdoren ekskluzivisht për blerjen e pajisjeve të Maternitetit të Ri të Tiranës i cili është pjesë përbërëse e Spitalit Universitar Obstetrik Gjinekologjik

Huamarrësi merr përsipër të mbulojë të gjitha shpenzimet që i referohen transferimit dhe instalimit të pajisjeve.

Shuma dhe Disbursimi

Subjekt i termave dhe kushteve të mësipërme, Huadhënësi bie dakord t’i huajë Huamarrësit deri në GRD 1,500,000,000 (Njëmiliardepesëqindmilionë) Dhrahmi Greke për Projektin.

Pas përmbushjes së kushteve të lidhura me Nenin 4, më tutje, Huadhënësi do të disbursojë Huanë duke kredituar në Dhrahmi Greke një llogari të specifikuar nga Huamarrësi në Datën e Tërheqjes. Huamarrësi do të kërkojë një sasi të disbursimit e cila do të jetë jo më pak se GRD – një qind milionë (100 000.000) duke i dhënë një njoftim me shkrim sipas formës së Pasqyrës A, Huadhënësit, të paktën njëzet(20) Ditë Pune para një date Tërheqje të kërkuar në një njoftim të tillë. Është rënë dakord që, Huadhënësi, mund të zbrësë nga shuma e Disbursimit në datën e Tërheqjes ndonjë shpenzim të përshkruar më poshtë të pësuar nga Huadhënësi para Datës së Tërheqjes. Disbursimi, sipas kësaj Huaje, do të kryhet në përputhje me grafikun e pagesave të përshkruara në Kontratën e Blerjes.

Interesi

Norma e interesit e aplikueshme mbi këtë Hua do të jetë 5% (pesë përqind) në vit. Periudha e Parë e Interesit e lidhur me çdo transh (përveç transhit të parë) do të përfundojë në ditën e fundit të Periudhës së Interesit të lidhur me Transhin e parë i cili është aktual në datën në të cilën transhi vijues është huamarrë pas Transhit të parë dhe çdo transh vijues do të përqendrohet dhe do të trajtohet si një Transh i vetëm me qëllim Periudhën e Interesit vijues. Interesi mbi masën e transhit do të jetë detyrim dhe i pagueshëm në gjysmën e vitit në detyrimin në çdo datë të pagesës së interesit.

Nëse Huamarrësi do të dështojë në ndonjë pagesë të Interesit ose të shumës së huasë fillestare(principalit) në datën e caktuar, Huamarrësi, do të jetë në vështirësi sipas kalimit të afatit të kësaj date pa ndonjë njoftim të kësaj shtyrje dhe do të jetë i detyruar të paguajë interesa mbi këtë shumë të papaguar (në vend të normës së interesit referuar si më sipër) me normën e interesit prej 6(gjashtë)përqind në vit në ditën e fundit të çdo muaji ndjekur nga një datë detyrimi deri në datën kur shuma për të cilën është dështuar në pagesë të paguhet në tërësi.

Proporcioni i interesit të Huasë ndaj normës së interesit në GRD(dhrahmi Greke) të ofruar nga Qeveria Greke në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes do të jetë e njëjtë me normën e interesit në EURO në datën e zëvendësimit të GRD me EURO.

Ripagimi i Huasë

Huamarrësi do të ripaguajë Huanë të tërën me (37) këste gjashtë mujore. Kësti i parë i Ripagesës do të kryhet në datën e cila bie (84) muaj pas datës të huamarrjes së parë dhe Këstet për Ripagimin do të bëhen me intervale gjashtë mujore me një Këst Ripagimi final në përvjetorin e njëzet e pestë të datës së huamarrjes së parë si më tutje.

Ripagimi Vullnetar

Huamarrësi mund të parapaguajë ndonjë pjesë të shumës së përgjithshme të Huasë në çdo kohë.

Taksat

Ndonjëra dhe të gjitha taksat të cilat ekzistojnë tani ose mund të vendosen në të ardhmen mbi interesin dhe/ose në lidhje me ekzekutimin, regjistrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose në lidhje me ndonjë interes sigurimi të lindur duke respektuar Huanë, ndonjë detyrim pulle, dhe kosto e shpenzime të tjera të ndodhura në lidhje me ekzekutimin, regjistrimin, menaxhimin dhe shërbimin ndaj Marrëveshjes së Huasë do të bien ekskluzivisht mbi Huamarrësin.

Kështu, të gjitha shumat e pagueshme nga Huamarrësi, këtu e më tutje, qofshin shuma të principalit, interesa, tarifa shërbimi, shpenzime ose të tjera do të paguhet në tërësi, të çliruara nga ndonjë zbritje ose ndalesë për ndonjë dhe të gjithë taksat e tashme dhe të ardhme, detyrime, taksa, taksa pulle, tarifa, zbritje, pagesa, ndalesa dhe të gjitha detyrimet e lindura duke respektuar këtë (këtu, kolektivisht do të referohen si "Taksat"). Nëse, gjithësesi ndonjë zbritje ose ndalesë aplikohet, Huamarrësi do të paguajë të gjitha shumat shtesë të nevojshme për të siguruar që shuma neto e përfituar aktualisht, nga Huadhënësi, me një shumë ekuivalente si në rastin kur Huadhënësi do të përfitonte kur nuk do të kërkoheshin zbritje dhe ndalesa të tilla.

Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin për ndonjë pagesë të Taksave të cilat duhet të bëhen nga Huadhënësi dhe Huamarrësi do të paguajë apo rimburojë Huadhënësin për to, brenda 30 ditësh.

Përlllogaritjet, në besim të mirë të Huadhënësit, për shumën e detyrimit të Huamarrësit në zbatim të fjalisë në vazhdim do t'i furnizohet Huamarrësit në detaje të arsyeshme dhe do të jetë përfundimtare dhe e varur nga Huadhënësi.

Rimbursimi i Shpenzimeve

i) Huamarrësi do të paguajë ose rimburojë Huadhënësin, sipas kërkesës, kostot e arsyeshme të paparashikuara(out-of-pocket) të Huadhënësit dhe shpenzimet e ndodhura në lidhje me ekzekutimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dhe Dokumentet e tjera të Financimit, përfshirë, pa kufizim, autentifikimin, regjistrimin e ndonjë Dokumenti Financimi. Huamarrësi, do të ndajë me Huadhënësin sipas kërkesave për të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë, pa kufizim, pagesa noteri dhe shpenzime) të kryera nga Huadhënësi për hyrjen e plotë në fuqi dhe me efekte ose përforcimin e të drejtave të këtushme ose të ndodhur në lidhje me modifikime, amendime ose anashkalime të ndonjë parashikimi të ndonjë dokumenti të tillë.

ii) Për të gjitha shpenzimet e përziera për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Projektit sikurse një kompensim i anëtarëve të Komitetit të Përbashkët dhe të Komitetit të Vëzhgimit do të bihet dakord me një letër të veçantë dhe mund të mbulohen nga produkti i Huasë.

Monedha dhe Vendi i Pagesës

Të gjitha pagesat e kërkuara si më poshtë do të bëhen në Dhrahmi Greke menjëherë sapo fondet

të jenë të disponueshme pa ndonjë zbritje për Taksa ose për ndryshe, në Llogarinë Korrente të Shtetit Grek no.200 në Bankën e Greqisë. Nëse ndonjë ditë pagese nuk është Ditë Pune, pagesa do të bëhet në Ditën vijuese të Punës.

Përlllogaritja e Interesit mbi Huanë

Përveçse nëse e parashikuar ndryshe, këtu, interesi do të përlllogaritet mbi bazën e konvencionit të numërimit 360-ditësh dhe në numrin aktual të ditëve të kaluara.

Aplikimi i Pagesave ndaj Huadhënësit

Pagesat e përfituara nga Huadhënësi sipas kësaj Marrëveshjeje, do të aplikohen në pagesën e së pari, Taksat, nëse ka ndonjë, dhe Rimbursimet e Shpenzimeve nëse ka, së dyti, ndonjë detyrim të kaluar dhe interesa të papaguara; së treti ndonjë interes aktual pastaj detyrim; së katërti, shumat të principalit pastaj detyrim; së pesti ndonjë parapagim vullnetar.

Neni 3

Përfaqësimi dhe garancitë

Huamarrësi përfaqëson, premtion dhe garanton, Huadhënësin që:

Ekzistenca e Fuqisë së Huamarrësit

Huamarrësi ka fuqinë për të marrë hua para dhe të krijojë një ngarkesë në pronat e tij, të bëjë dhe të ekzekutojë çdo Dokument Financimi tek i cili është ose do të jetë palë.

Autoriteti i Huamarrësit

Ekzekutimi, lëvrimi dhe performimi i secilit nga Dokumentet e Financimit tek i cili është ose do të jetë palë: (i) ka qenë tërësisht i autorizuar me të gjitha veprimet e nevojshme; (ii) nuk do të shkelë ndonjë rregullorë të aplikueshme ose rregull të ndonjë autoriteti qeveritar; dhe (iii) nuk do të thyejë ose të rezultojë në kundërshtim me ndonjë barrë për ndonjë nga mjetet sipas ndonjë marrëveshjeje ose kërkesë tjetër ndaj së cilës ai ose ndonjë nga pronat e tij është në detyrim ose nën influencë.

Mjetet

Huamarrësi nuk është veças dhe as kontraktualisht i shtrënguar të krijojë, ndonjë borxh, premtime financiare, barra financiare ose ndonjë formë tjetër interes sigurimi ose nga pronat e tij aktuale ose të ardhshme, të ardhura ose mjete për të siguruar ndonjë borxh.

Dështimi

Huamarrësi, nuk është në thyerje të ndonjërit nga parashikimet e ndonjë kontrate tek e cila Huamarrësi është palë dhe që do të ketë efekt material të kundërt mbi kushtet financiare të Huamarrësit ose mbi aftësinë për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Dokumenti Financiar. Asnjë ngjarje nuk ka ndodhur, e cila të krijojë një dështim sipas ose duke respektuar ndonjë marrëveshje apo dokument ndaj të cilit Huamarrësi është palë ose sipas, të cilit Huamarrësit mund të detyrohet dhe asnjë dështim nuk ka ndodhur dhe po vazhdon e pakorrigjuar ose do të rezultojë nga huamarrja (ose ndonjë pjesë e saj) ose performimi nga Huamarrësi për detyrimet sipas Dokumenteve të Financimit.

Mosmarrëveshjet

Asnjë veprim, çështje gjyqësore procedim ose hetim është i dallueshëm nga ose përpara ndonjë gjykate të huaj ose autoriteti qeveritar ose, sipas njohjes së Huamarrësit pas detyrimit është kërcënues kundrejt Huamarrësit, ose për ndonjë nga pronat apo të drejtat e tij që, nëse e përcaktuar në të kundërt, është i mundshëm për influenca materiale të kundërta në kushtet e tij financiare ose në aftësitë për të përmbushur detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndaj ndonjë Dokumenti Financimi.

Përputhja me ligjin

Huamarrësi do të ketë përfituar të gjitha miratimet materiale, aprovimet dhe autorizimet dhe ka konkluduar të gjitha deklaratimet, regjistrimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrimeve, lëvrimeve dhe performimit nga Huamarrësi të çdo Dokumenti Financimi tek, i cili është apo do të jetë palë, përveçse tek ato të lidhura me të operacioneve të ardhme dhe transaksione, të cilat pritet të përfitohen me kalimin

e kohës dhe ato që iu referohen aprovimit Qeveritar si këtu.

Transparenca

Të gjitha dokumentet, raportet ose informacion tjetër që i përket Projektit (përfshirë, pa kufizim këtë Marrëveshje), i cili i është dhënë Huadhënësit është i vërtetë dhe korrekt dhe nuk përmban ndonjë deklaram të gabuar material të fakteve ose mungesa në përcaktim të një fakti material, që i bën deklaramet e dhëna këtu ose në brendësi të keqkuptueshme.

Neni 4

Kushte të mëparshme për disbursimet

Përveçse kur Huadhënësi bie dakord ndryshe me shkrim, detyrimi i Huadhënësit për të kryer Disbursimet e Huasë është subjekt i përmbushjeve të mëparshme të kërkesave të Huadhënësit me zgjedhjen e tij, të kushteve të mëposhtme të mëparshme dhe ndaj përmbushjes së vazhdueshme në ndonjë Datë Tërheqjeje.

Autorizimet

Huadhënësi do të ketë marrë në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për të, të mëposhtmet:

Një kopje e të gjitha dokumenteve që ratifikojnë këtë Marrëveshje, siç kërkohet nga Kushtetuta dhe Ligjet e Huamarrësit, të certifikuar si kopje autentike nga një Zyrtar i Autorizuar i Huamarrësit; dhe

Një kopje e një Vendimi të Qeverisë Shqiptare, i cili aprovon këtë Marrëveshje dhe autorizon një person të caktuar ose persona për të ekzekutuar këtë marrëveshje në emër të Qeverisë së Huamarrësit, të certifikuar si një kopje autentike nga Zyrtari i Autorizuar i Huamarrësit.

Një certifikatë nga Zyrtari i Autorizuar, që certifikon emrat, titujt, firmat e personave, të cilët janë autorizuar të ekzekutojnë dhe lëvrojnë në emër të Huamarrësit në aftësinë e tij si përfaqësues i Huamarrësit këtu e më poshtë, kjo marrëveshje dhe të gjitha njoftimet e tjera ose instrumentet e ndërmendura këtu e më poshtë.

Miratimet e Qeverisë

Huadhënësi do të ketë marrë kopjet e certifikuar nga Zyrtari i Autorizuar i Huamarrësit si kopje të vërteta dhe me fuqi të plotë dhe efekt i ndonjë ratifikimi, regjistrimi, miratimi, apo aprovimi qeveritar të kërkuar ose të marrë në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjet e Huamarrësit ose të nevojshme për Protokollin, kjo Marrëveshje, Huaja dhe pagesa e të gjitha shumave detyrim ose që do të bëhen detyrim, duke respektuar si vijon, nuk do të jenë subjekt i ndonjë Takse.

Opinione Ligjore

Huadhënësi do të ketë marrë opinione me shkrim të datura më Datën e Tërheqjes, ku secili prej tyre do të jetë në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Huadhënësin, (i), i këshillit special ligjor të tij në Tiranë dhe (ii) i këshillit ligjor të Huamarrësit.

Marrëveshja e Blerjes

Huadhënësi do të ketë marrë kopjet e certifikuar nga Zyrtari i Autorizuar i Huamarrësit për Marrëveshjen e Blerjes.

Përfaqësimet dhe Garancitë

Përfaqësimet dhe garancitë e dhëna në Nenin III, këtu më sipër, do të jenë të vërteta dhe korrekte në Datën e Disbursimit, sikurse në qoftë se është bërë në një datë të tillë, dhe në një datë të tillë, jo Ngjarje Dështimi (si përcaktohet këtu më pas) dhe jo rrethanë ose kusht i cili me kalimin e kohës ose me dhënien e njoftimit, ose të dyja, do të krijonte një Ngjarje Dështimit, do të ekzistojë.

Ndryshimi në Rrethanat

Në kohën e Disbursimit, asnjë rrethanë ose ndryshim i ligjit ose rregullores të ndonjë autoriteti qeveritar nuk do të ketë ndodhur çka në gjykimin e arësyeshëm të Huadhënësit do të ndikojë materialisht në të kundërt kushtet financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e tij si këtu e mëposhtë.

Çertifikimi

Huamarrësi do t'i ketë dorëzuar Huadhënësit një certifikatë, në formë dhe përmbajtje të kënaqshme për Huadhënësin, të firmosur nga Zyrtari i Autorizuar i Huamarrësit me të cilën certifikon përmbushjen e secilit nga kushtet e përcaktuara më parë tek Përfaqësime dhe Garanci efektive si në datën e kërkuar të një Disbursimi të tillë dhe duke certifikuar se procedurat e Disbursimit janë në mënyrë prezente të nevojshme për qëllime të Projektit.

Neni 5

Premtime pohuese

Përveçse nëse Huadhënësi bie dakord ndryshe me shkrim, për sa kohë Angazhimi do të mbetet i dallueshëm dhe derisa pagesa në tërësi e të gjitha shumave detyrim dhe që do të bëhen detyrim, si këtu dhe më poshtë, Huamarrësi, premtion dhe bie dakord si vijon:

Detyrimet e Huamarrësit

Huamarrësi do të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje dhe të secilit tjetër Dokument të Financimit tek i cili ai është palë.

Njoftimi i Dështimit dhe çështje të tjera

Huamarrësi, do të njoftojë menjëherë Huadhënësin për (i) ndodhjen e çdo Ngjarjeje Dështimi dhe të çdo ngjarjeje të njohur nga ndonjë prej zyrtarëve të tij, e cila mbi dhënien e njoftimit, kalimin e kohës, ose të dyja, do të bëhet një Ngjarje Dështimi, dhe (ii) ndodhja e ndonjë kushti tjetër ose ngjarje (përfshirë veprime të qeverisë), e cila është e mundshme të ndikojë materialisht në të kundërt kushtet financiare të Huamarrësit ose aftësinë e tij për të kryer detyrimet e tij sipas ndonjë Dokumenti Financimi.

Neni 6

Premtime mohuese

Përveçse nëse Huadhënësi, bie dakord ndryshe me shkrim, për sa kohë Angazhimi do të mbetet i dallueshëm dhe derisa pagesa në tërësi e të gjitha shumave detyrim dhe që do të bëhen detyrim, si këtu më poshtë, Huamarrësi premtion dhe bie dakord si vijon:

Mosndryshimi i Marrëveshjeve

Huamarrësi nuk do të përfundojë, amendojë ose japë ndonjë dorëheqje nga, ose ngarkim të ndonjë nga detyrimet ose obligimet e tij, sipas ndonjë parashikimi të ndonjë Dokumenti Financimi, tek i cili ai është palë (përveç amendimeve ose dorëheqjeve për të korrigjuar gabime të aparcencës ose të cilat janë të formës, të vogla ose të natyrës teknike dhe nuk ndryshojnë materialisht ndonjë të drejtë ose detyrim të Palëve).

Drejtimi i Zakonshëm i Punëve

Huadhënësi nuk do të:

- ndryshojë materialisht natyrën ose qëllimin e Projektit;
- ndryshojë ligjin e tij në mënyrën në të cilën do të jetë jo në përputhje me parashikimet e ndonjë prej Dokumenteve të Financimit.

Neni 7

Dështime dhe ndreqje

Ngjarjet e dështimit

Ndodhia dhe vazhdimi i ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme ose rrethanave do të përcaktohet një "Ngjarje Dështimi" këtu e më poshtë kur:

Huamarrësi dështon në pagesën në mënyrë të përpiktë, kur detyrohet për ndonjë interes apo

shumë të principalit mbi ndonjë nga Borxhet e tij të Jashtme dhe një dështim i tillë do të vazhdojë përtej periudhës së faljes, nëse ka ndonjë të tillë, e aplikueshme tek; ose një dështim ndodh sipas ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti duke evidentuar ose sipas të cilit Huamarrësi ka veçuar në kohë ndonjë Borxh të Jashtëm të tillë dhe një dështim i tillë është për të përshpejtuar ose për të lejuar përshpejtimin dhe pjekurinë e një Borxhi të Jashtëm të tillë; ose

Një përfaqësim ose garanci të bërë nga ose në emër të Huamarrësit në këtë Marrëveshje, ose në ndonjë njoftim ose certifikatë tjetër, dokument, deklaram financiar ose tjetër i lëvruar në zbatim të saj, do të provojë të ketë qenë jokorrekt në ndonjë respektim material kur është kryer; ose

Kjo Marrëveshje për ndonjë arsye ndalon së qeni në fuqi të plotë dhe me efekte ose është deklaruar për të qenë e pavlefshme ose është e hedhur poshtë ose vlefshmëria ose imponueshmëria e këtushme ose sipas kësaj është në çdo kohë e kundërshtuar nga Huamarrësi; ose

Të gjitha ose një pjesë e gjërë e mjeteve të Huamarrësit do të shpronësohen nga ndonjë autoritet ose Huamarrësi do të transferojë ose do të verë në dispozicion të gjitha ose një pjesë të gjërë të mjeteve të tij.

Një pezullim i përgjithshëm është deklaruar mbi pagesën e ndonjë Borxhi të jashtëm për paratë e huajtura nga Huamarrësi.

Ndonjë Borxh i Jashtëm i Huamarrësit (i) nuk është paguar në datën e caktuar ose brenda ndonjë periudhe faljeje të specifikuar në marrëveshje të lidhura (ii) bëhet detyrim dhe i pagueshëm përpara maturimit të tij normal për arsye të një dështimi ose ngjarjeje dështimi gjithësesi të përshkruar, sipas ndonjë marrëveshjeje tek e cila Huamarrësi është palë.

Ndreqje të Ngjarjes së Dështimit

Nëse ndonjë Ngjarje Dështimi ka ndodhur dhe është në vazhdim, Huadhënësi, mundet në çdo kohë në gjykimin e tij të vetëm, (i) të pezullojë ose përfundojë Angazhimin, (ii) deklarojë, me kërkesë me shkrim për pagesë të Huamarrësit, ndonjë pjesë ose të gjithë shumën principale të veçantë të Huasë për të qenë detyrim dhe e pagueshme sipas kësaj, një pjesë e tillë e Huasë do të maturohet menjëherë dhe do të bëhet detyrim dhe e pagueshme bashkë me interesat e rrjedhura si më lart, pa ndonjë paraqitje tjetër, kërkesë, aplikim, protestë, njoftim përshpejtimi, ose ndonjë njoftim të çdo lloji, të gjitha nga çka Huamarrësi me anë të kësaj, kategorikisht heq dorë, dhe/ose (iii) pa ndonjë njoftim të dështimit ose kërkesë, procedon për të mbrojtur dhe ndikon të drejtat e tij dhe ndreqjet me procedimet përkatëse, edhe në raste për dëmtime ose shfaqje specifike ndaj ndonjë parashikimi të kësaj marrëveshjeje ose në ndihmë të ushtrimit të ndonjë pushteti të dhënë në këtë Marrëveshje, ose me ligj.

Juridiksioni dhe aprovimi i Gjykatës

Palët, me këtë, bien dakord, në mënyrë të paanullueshme, që gjykatat e Republikës Helene do të kenë juridiksion të dëgjojnë dhe të zgjidhin ndonjë çështje gjyqësore, veprim, ose procedim dhe të vendosin për ndonjë mosmarrëveshje që mund të lindë nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje, dhe për qëllime të tilla i dorëzohen juridiksionit të këtyre gjykatave. Huamarrësi me këtë, në mënyrë të paanullueshme heq dorë nga ndonjë objeksion i tanishëm ose i ardhshëm ndaj një ndodhie të tillë, dhe në mënyrë të paanullueshme jep pëlqimin dhe dorëzohet pa kushte tek një juridiksion jo eksklusiv për vetveten dhe si rrjedhim tek ndonjë nga pronat e ndonjë gjykate të tillë. Huamarrësi për më tepër në mënyrë të paanullueshme heq dorë nga ndonjë pretendim që ndonjë nga gjykatat nuk është forum i përshtatshëm për ndonjë procedim. Huamarrësi bie dakord që ndonjë shërbim i procesit, vendim, gjykim ose njoftim tjetër i procesit ligjor do të gjykohet dhe mbahet duke respektuar të qenit efektiv në shërbim ndaj tij. Asgjë këtu nuk do të ndikojë në të drejtën e Huamarrësit ose të Huadhënësit për t'i shërbyer procesit në ndonjë mënyrë tjetër të lejuar nga ligji, i cili është i aplikueshëm. Huamarrësi për më tepër bie dakord që gjykimi final kundër tij në ndonjë veprim ose procedim të lindur nga lidhjet me këtë Marrëveshje, do të jetë përfundimtar dhe do të ndikojë dhe ekzekutojë kundër Huamarrësit dhe mjeteve të tij dhe ndërtesave të vendosura brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim gjykate, një kopje të certifikuar e së cilës do të jetë provë përfundimtare e faktit dhe e shumës së borxhit të tij.

Neni 8
Të ndryshme

Njoftimet

Çdo raport, njoftim dhe komunikim tjetër, i cili duhet dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim në gjuhën angleze, do të dërgohet me dorë, postë, telegram, ose teleks, postë të parapaguar, dhe do të prezumohet të jetë dhënë në rrëgull kur merret në një nga adresat si vijojnë:

Tek Huamarrësi:

Ministria e Financave
Drejtoria e Financave Ndërkombëtare dhe e Borxhit të Jashtëm
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1
Tiranë, Shqipëri
Tel/fax; (35542) 292 00

Tek Huadhënësi:

Ministria e Ekonomisë Kombëtare
Sekretariati i Përgjithshëm për Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare
Drejtoria e Europës Qendrore dhe Lindore
1, Rruga Cornarou
GR – 101 80, Athinë – Greqi
Telefon: (01) 328 62 01/328 62 48
Faks: (01) 328 62 09

Ndonjë palë me njoftim me shkrim të palës tjetër mund të ndryshojë adresën, tek e cila komunikimet duhet të dërgohen.

Mbikëqyrja

Blerja dhe instalimi i pajisjeve të klinikës Materniteti do të monitorohen nga Komiteti i Vëzhgimit, i cili do të paraqesë raporte tek Komiteti i Përbashkët për zbatimin e Protokollit. Detajet referuar krijimit dhe funksionimit të Komitetit të Vëzhgimit do të përcaktohen në një fazë të mëvonshme.

Ligji Udhëheqës, titujt shprehës

Kjo Marrëveshje do të udhëhiqet nga dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës Helene. Titujt në Marrëveshje janë vetëm për qëllime referimi dhe nuk kufizojnë ose influencojnë kuptimin e saj.

Agjenti i procesit

Huamarrësi emëron me këtë, ambasadorin e Huamarrësit në Athinë, të veprojë me gjykimin e vetëm të Huadhënësit si një agjent i tij i procesit dhe këshilltar tek, i cili Huadhënësi mund të njoftojë çdo dokument, teleks, ose transmetim dhe për më tepër ndonjë dokument ligjor të lidhur drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt me këtë Marrëveshje dhe ndonjë dokument tjetër.

Rradha

Kjo Marrëveshje do të kontribuojë drejt përfitimit të dhe do të jetë e kufizuar sipas përfituesve dhe ngarkimit të palëve, duke pasur parasysh atë që Huadhënësi pa një pëlqim paraprak me shkrim të dhënë nga Huadhënësi, nuk do të ngarkojë ose delegojë të gjitha ose pjesë të interesave ose të detyrimeve.

Qëndresa e Marrëveshjeve

Çdo Marrëveshje, përfaqësim dhe garanci e përmbajtur këtu ose së cilës i referohet kjo Marrëveshje do t'i qëndrojë ndonjë hetimi në çdo kohë të bërë nga Huadhënësi dhe disbursimi i Huasë,

përveçse për ndryshimet e lejuara sipas saj, dhe do të përfundojë vetëm kur e gjithë shumta detyrim ose që do të bëhet detyrim sipas kësaj marrëveshjeje të jetë paguar tërësisht.

Përfshirja, amendamentet

Kjo Marrëveshje mishëron kuptimin e plotë të palëve këtu dhe zëvendëson të gjitha negociatat e mëparshme, kuptimet dhe marrëveshjet mes tyre si rrjedhim i çështjes subjekt i këtushëm. Parashikimet e kësaj Marrëveshje mund, të shtohen, amendohen ose të hiqet dorë prej tyre, vetëm nëpërmjet një instrumenti me shkrim i firmosur nga përfaqësues të autorizuar në rregull të Huamarrësit dhe të Huadhënësit.

Moslejimi i dorëheqjes

Asnjë negociim, dështim ose vonesë nga Huadhënësi në ushtrimin e ndonjë të drejte, pushteti ose ndreqjeje këtu e më poshtë nuk do të shërbejë si veprim për të hequr dorë sa më lart ose përndryshe do të paragjykojë të drejtat e Huadhënësit, pushtetin ose mjetin. Asnjë e drejtë, pushtet ose mjet i akorduar mbi Huadhënësin sipas kësaj, nuk do të predominojë mbi ndonjë të drejtë, pushtet ose mjet tjetër referuar sa këtu ose më tej ose tani, ose, këtu e më pas të disponueshme të parashikuar me ligj, me paanësi, me statut, ose ndryshe.

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas ratifikimit të saj përfundimtar nga Parlamenti Shqiptar dhe ratifikimit të Protokollit nga Parlamenti Grek.

Në dëshmi të kësaj, secila nga palët këtu, ka lidhur këtë Marrëveshje për t'u ekzekutuar dhe lëvruar në dy kopje në gjuhën Angleze në emër të dhe nga përfaqësuesi i autorizuar, i duhur, në datën e caktuar në fillim të saj.

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS HELENE
Yannis Zafeiropoulos
Zëvendësministër i Ekonomisë Kombëtare

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Anastas Angjeli
Ministër i Financave

AMENDAMENT I MARRËVESHJES SË HUASË TË SPECIFIKUAR NË KUADRIN E PROTOKOLLIT MBI BASHKËPUNIMIN EKONOMIK TË FIRMOSUR MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS HELENE DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË

Qeveria e Republikës Helene dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë, bien dakord që të gjitha shpenzimet e ndryshme për koordinimin dhe monitorizimin e zbatimit të Projektit të financuar brenda kuadrit të huave të dhëna Qeverisë së Republikës së Shqipërisë nga Qeveria e Republikës Helene në zbatim të Protokollit të Bashkëpunimit Ekonomik, si dhe shpërblimi i anëtarëve të Komitetit të Përbashkët dhe Komitetit të Vëzhgimit do të përcaktohen në një Letër të veçantë dhe mund të mbulohen nga produkti i Huasë.

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS HELENE
Yannis Zafeiropoulos
Zëvendësministër i Ekonomisë Kombëtare

PËR QEVERINË E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Anastas Angjeli
Ministër i Financave

PASQYRA A

Për: Ministria e Ekonomisë Kombëtare

Data

ATHINË

Në zbatim të nenit 1 të Marrëveshjes së Huasë të datës (.....), 1998 (“Marrëveshja e Huasë”) mes nesh si Huamarrës dhe jush si Huadhënës, si rrjedhim i Huasë prej GRD 1, 500, 000, 000 ne me këtë ju japim njoftimin e huamarrjes së propozuar si vijon:

- (a) Data.....
- (b) Shuma.....
- (c) Udhëzimet e pagesës:.....

Ne konfirmojmë se Përfaqësimet dhe Garancitë e vendosura në nenin III të Marrëveshjes së Huasë, janë të vërteta dhe të sakta, në datën e përcaktuar këtu, si bërë në një datë të tillë, dhe asnjë Dështim (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Huasë) nuk ka ndodhur dhe nuk vazhdon ose do të rezultojë nga Huaja e propozuar.

L I G J

Nr.8703, datë 1.12.2000

PËR RATIFIKIMIN E “KONVENTËS EUROPIANE PËR INFORMIMIN PËR TË DREJTËN E HUAJ”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Konventa Europiane për informimin për të drejtën e huaj”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2828, datë 8.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

KONVENTA EUROPIANE PËR INFORMIMIN MBI TË DREJTËN E HUAJ

Seria e marrëveshjeve europiane nr.62

Londër, 7.6.1968

HYRJE

Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, nënshkrues të kësaj Konvente,

Duke marrë në konsideratë se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë mes anëtarëve të tij,

Të bindur që krijimi i një sistemi të ndihmës së ndërsjellë shtetërore me qëllim, lehtësimin e detyrave të autoriteteve gjyqësore në marrjen e informacionit mbi të drejtën e huaj do të kontribuojë në realizimin e këtij qëllimi,

Kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

Qëllimi i konventës

1. Palët kontraktuese marrin përsipër të japin informacion sipas parashikimeve të kësaj konvente, lidhur me legjislacionin e tyre në fushën civile dhe tregtare, sikurse dhe në fushën procedurale civile dhe tregtare dhe në fushën e organizimit të tyre gjyqësor.

2. Sidoqoftë, dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shtrijnë brenda tyre zbatimin e kësaj konvente në fusha të tjera nga ato të përmendura në paragrafin e mësipërm. Teksti i kësaj marrëveshjeje do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 2

Organet kombëtare të lidhjes

1. Për zbatimin e kësaj konvente, çdo palë kontraktuese do të krijojë ose caktojë një organ të vetëm (këtej e tutje të quajtur "organi pritës"), që do të ketë për detyrë:

a) Marrjen e kërkesave për informacionin sipas nenit 1 paragrafi I parë të kësaj konvente, që vijnë nga një palë tjetër kontraktuese;

b) Të veprojë lidhur me këto kërkesa në përputhje me nenin 6.

Ky organ duhet të jetë një departament ministrie, ose një organ tjetër shtetëror.

2. Çdo palë kontraktuese do të ketë të drejtën të krijojë ose caktojë një ose më shumë organe (këtej e tutje të quajtur "organe transmetues"), të ngarkuar me marrjen e kërkesave për informacion nga autoritetet e tij gjyqësore dhe t'ua transmetojë ato organit marrës të huaj kompetent. Organi marrës mund të veprojë si në organ transmetues.

3. Çdo palë kontraktuese do t'i komunikojë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës emrin dhe adresën e organit të tij marrës dhe, kur është vendi, të organit ose organeve të tij transmetuese.

Neni 3

Autoritetet e autorizuara për të bërë kërkesa për informacion

1. Një kërkesë për informacion duhet të rrjedhë kurdoherë nga një autoritet gjyqësor, edhe kur ajo nuk është formuluar nga ky i fundit. Kërkesa mund të bëhet vetëm kur një procedurë gjyqësore ka filluar.

2. Çdo palë kontraktuese mundet të tregojë, nëse nuk ka ngritur apo caktuar një organ transmetues, me anë të një deklaratë të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, cilat

nga autoritetet e saj do të konsiderohen prej saj si autoritete gjyqësore sipas kuptimit të paragrafit të mësipërm.

3. Dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shtrijnë brenda tyre zbatimin e kësaj konvente për kërkesa të rrjedhura nga autoritete të tjera nga ato gjyqësore. Teksti i kësaj marrëveshjeje do t'i komunikohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 4

Përmbajtja e kërkesës për informacion

1. Kërkesa për informacion duhet të tregojë autoritetin gjyqësor nga rrjedh, sikurse dhe natyrën e çështjes. Ajo duhet të saktësojë sa më shumë të jetë e mundur pikat për të cilat kërkohet informacioni lidhur me legjislacionin e shtetit të kërkuar, dhe në rastin e ekzistencës së shumë sistemeve juridike në shtetin e kërkuar, sistemin juridik për të cilin kërkohet informacioni.

2. Kërkesa do të shoqërohet nga paraqitja e fakteve të nevojshme si për mirëkuptimin e saj dhe për formulimin e një përgjigjeje të saktë dhe precize. Kopje të dokumenteve mund t'i bashkëlidhen kur është e nevojshme për të sqaruar qëllimin e kërkesës.

3. Kërkesa mund të përfshijë pyetje në fusha të tjera nga ato të treguara në nenin 1, paragrafi i parë, sa kohë që ato lidhen me pyetjet kryesore të specifikuar në kërkesë.

4. Në rast se kërkesa nuk është hartuar nga një autoritet gjyqësor, ajo do të shoqërohet nga vendimi i këtij autoriteti që autorizon bërjen e saj.

Neni 5

Transmetimi i kërkesës për informacion

Kërkesa për informacion do t'i transmetohet direkt organit marrës të shtetit të kërkuar nga një organ transmetues, ose në mungesë të një organi të tillë, nga autoriteti gjyqësor nga ajo rrjedh.

Neni 6

Autoritetet kompetente për t'u përgjigjur

1. Organi marrës që ka marrë kërkesën për informacion mund ta hartojë vetë përgjigjen, ose ta transmetojë kërkesën tek një organ tjetër shtetëror ose zyrtar për ta hartuar ai përgjigjen.

2. Organi marrës mund, në raste të caktuara ose për arsye të organizimit administrativ, t'ia transmetojë kërkesën një organizmi privat ose një juristi të kualifikuar për të hartuar përgjigjen.

3. Nëse zbatimi i paragrafit të mësipërm shoqërohet me shpenzime, organi marrës, para bërjes së transmetimit të treguar në paragrafin në fjalë, do t'i tregojë autoritetit nga rrjedh kërkesa, organizmin privat ose juristin të cilit do t'i transmetohet kërkesa, dhe do të informojë autoritetin në fjalë sa më me kujdes të jetë e mundur për shpenzimet e mundshme, dhe do të kërkojë pëlqimin e tij për këtë.

Neni 7

Përmbajtja e përgjigjes

Objekti i përgjigjes do të ketë për qëllim dhënien e informacionit në mënyrë objektive dhe të paanshme për legjislacionin e shtetit të kërkuar, autoritetit gjyqësor nga i cili rrjedh kërkesa. Përgjigjja do të përmbajë sipas rastit, tekste ligjore dhe vendime gjyqësore. Ajo do të shoqërohet në mënyrën e gjykuar të nevojshme për një informim të mirë të autoritetit kërkues, nga çdo dokument tjetër plotësues, të tillë si ekstrakte nga punime doktrinale dhe materiale ligjore. Ajo mundet gjithashtu të shoqërohet nga komentare shpjegues.

Neni 8
Pasojat e përgjigjes

Informacionet e dhëna në përgjigje nuk janë të detyrueshme për autoritetin gjyqësor nga i cili rrjedh kërkesa.

Neni 9
Komunikimi i përgjigjes

Përgjigjja do t'i drejtohet organit transmetues nga organi marrës, nëse kërkesa është transmetuar nga ky organ, ose autoritetit gjyqësor nëse kërkesa është dërguar nga ky i fundit.

Neni 10
Detyrimi për t'u përgjigjur

1. Organi marrës, të cilit i është dërguar kërkesë për informacion, nën rezervën e parashikimeve të nenit 11 do të veprojë për trajtimin e kërkesës në përputhje me nenin 6.
2. Nëse përgjigjja nuk është formuluar nga organi marrës, ky i fundit angazhohet të sigurojë që përgjigjja është dërguar në kushtet e parashikuara nga neni 12.

Neni 11
Përfundime nga detyrimi për t'u përgjigjur

Shteti i kërkuar mund të refuzojë ndërmarrjen e veprimeve për kërkesën për informacion nëse interesat e tij preken nga çështja e ngritur në kërkesë, ose nëse ai konsideron që përgjigjja mund të paragjykojë sovranitetin ose sigurinë e tij.

Neni 12
Afati për dhënien e përgjigjes

Përgjigjja për një kërkesë për informacion do të dërgohet sa më shpejt të jetë e mundur. Sidoqoftë, nëse përgatitja e përgjigjes kërkon një kohë të gjatë, organi marrës do të informojë për këtë autoritetin e huaj kërkuar dhe nëse është e mundur do të tregojë në të njëjtën kohë datën e mundshme brenda së cilës përgjigjja do të komunikohet.

Neni 13
Informacion shtesë

1. Organi marrës, sikurse dhe organizimi ose personi i cili është ngarkuar e përputhje me nenin 6 të përgatisë përgjigjen, mund t'i kërkojë autoritetit nga i cili rrjedh kërkesa, t'i sigurojë çdo informacion tjetër shtesë që ai e konsideron të nevojshëm për përgatitjen e përgjigjes.
2. Kërkesa për informacion shtesë do të transmetohet nga organi marrës në të njëjtën mënyrë sikurse parashikohet në nenin 9 për komunikimin e përgjigjes.

Neni 14
Gjuhët

1. Kërkesat për informacion dhe anekset do të jenë në gjuhën ose në një nga gjuhët zyrtare të

shtetit të kërkuar, ose do të shoqërohen nga një përkthim në atë gjuhë. Përgjigjja do të jetë në gjuhën e shtetit të kërkuar.

2. Sidoqoftë, dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shmangen mes tyre nga parashikimet e paragrafit të mësipërm.

Neni 15 **Shpenzimet**

1. Përgjigjja nuk do të përmbajë pagesa të çfarëdo lloji ose shpenzime, me përjashtim të atyre të prashikuara në nenin 6, paragrafi i tretë, të cilat do të përballohen nga shteti nga i cili rrjedh kërkesa.

2. Sidoqoftë, dy ose më shumë palë kontraktuese mund të vendosin të shmangen mes tyre nga parashikimet e paragrafit të mësipërm.

Neni 16 **Shtetet federale**

Në shtetet federale, funksionet e organit marrës, të tjera nga ato të ushtruara sipas nenit 2, paragrafi i parë, shkronja “a”, mundet për arsye kushtetuese t’i delegohen organeve të tjera shtetërore.

Neni 17 **Hyrja në fuqi e Konventës**

1. Kjo konventë do të jetë e hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës. Ajo mund të ratifikohet ose pranohet. Instrumentet e ratifikimit ose të pranimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Kjo konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tretë të ratifikimit ose pranimit.

3. Për shtetet nënshkrues që e ratifikojnë ose e pranojnë këtë konventë më vonë, ajo do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit të tyre të ratifikimit ose pranimit.

Neni 18 **Aderimi i një shteti jo anëtar i Këshillit të Europës**

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj konvente, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo shtet jo anëtar të aderojë në këtë konventë.

2. Aderimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës të një instrumenti aderimi, i cili do të ketë efekt tre muaj pas datës së depozitimit.

Neni 19 **Zbatimi territorial i Konventës**

1. Çdo palë kontraktuese mundet, në momentin e nënshkrimit ose të depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose aderimit, të specifikojë territoret në të cilat do të zbatohet kjo konventë.

2. Çdo palë kontraktuese mundet, gjatë depozitimit të instrumentit të saj të ratifikimit, pranimit ose aderimit, ose në një datë të mëvonshme, nëpërmjet një deklarate të drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj konvente në cilindo territor ose territore të specifikuar në deklaratë, territore për të cilat ajo është përgjegjëse për marrëdhëniet ndërkombëtare, ose për të cilat ajo është e autorizuar të lidhë marrëveshje.

3. Çdo deklaratë e bërë në përputhje me paragrafin e mësipërm mund të tërhiqet përsa i përket territoreve të përmendura në atë deklaratë, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 20 të kësaj konvente.

Neni 20

Kohëzgjatja e Konventës dhe denoncimi i saj

1. Kjo konventë do të mbetet në fuqi për një afat kohor të pacaktuar.
2. Çdo palë kontraktuese mundet, përsa i përket asaj, të denoncojë këtë konventë nëpërmjet një njoftimi të dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.
3. Denoncimi do të ketë efekt gjashtë muaj pas datës së marrjes së njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 21

Funksionet e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do të njoftojë shtetet anëtare të Këshillit dhe çdo shtet tjetër, i cili ka aderuar në këtë konventë për:

- a) çdo nënshkrim;
- b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi ose aderimi;
- c) çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj konvente në përputhje me nenin 17 të saj;
- d) çdo deklaratë të marrë në përputhje me parashikimet e paragrafit të dytë të nenit 1, paragrafit të tretë të nenit 2, paragrafit të dytë të nenit 3 dhe paragrafeve dy dhe tre të nenit 19.
- e) çdo njoftim të marrë në përputhje me parashikimet e nenit 20 dhe datën në të cilën bëhet i efektshëm denoncimi.

Si dëshmi të kësaj, nënshkruesit të autorizuar si duhet për këtë gjë, kanë nënshkruar këtë konventë.

Bërë në Londër, më 7 qershor 1968, në frëngjisht dhe anglisht, të dyja tekstet njëllor të vlefshëm, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'i transmetojë kopje të vërtetuara secilit shtet nënshkrues dhe aderues.

L I G J

Nr.8705, datë 1.12.2000

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES EUROPIANE PËR TRANSMETIMIN E KËRKESAVE TË NDIHMËS GJYQËSORE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja Europiane për transmetimin e kërkesave të ndihmës gjyqësore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2829, datë 8.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

MARRËVESHJA EUROPIANE PËR TRANSMETIMIN E KËRKESAVE TË NDIHMËS GJYQËSORE

Seria e traktateve europiane nr.92

Marrëveshja STE nr.92 – Transmetimi i kërkesave të ndihmës gjyqësore, 1997

Shtetet anëtarë të Këshillit të Europës, nënshkrues të kësaj Marrëveshje,

Duke konsideruar se qëllimi i Këshillit të Europës është realizimi i një bashkimi më të ngushtë midis anëtarëve të tij;

Duke konsideruar se është e dëshirueshme të eliminohen pengesat ekonomike që dëmtojnë të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës civile dhe t’u lejojë personave ekonomikisht të pafavorizuar t’u vlerësohen më mirë të drejtat e tyre në Shtetet anëtare;

Të bindur se ngritja e një sistemi të transmetimit të kërkesave për ndihmë gjyqësore të përshtatshme do të kontribuojë për të arritur këtë qëllim,

Japin pëlqimin përse vijon:

Neni 1

Çdo person, që ka vendqendrimin e zakonshëm në territorin e njëres nga Palët kontraktuese, që dëshiron të kërkojë ndihmën gjyqësore në fushën civile, tregtare ose administrative në territorin e një Pale tjetër kontraktuese, mund të paraqesë kërkesën e tij në Shtetin e vendqendrimit të zakonshëm. Ky Shtet është i detyruar t’i transmetojë kërkesën Shtetit tjetër.

Neni 2

1. Çdo Palë kontraktuese cakton një ose disa autoritete dërguese të ngarkuara t’i transmetojnë drejtpërdrejt kërkesat për ndihmë gjyqësore autoritetit të huaj si më poshtë.

2. Çdo Palë kontraktuese cakton gjithashtu një autoritet qendror marrës i ngarkuar me marrjen e kërkesave për ndihmë gjyqësore që vijnë nga një Palë tjetër kontraktuese dhe me dhënien rrugë të tyre.

Shtetet federale dhe Shtetet në të cilët janë në fuqi disa sisteme të drejtash mund të caktojnë disa autoritete qendrore.

Neni 3

1. Autoriteti dërgues ndihmon kërkuesin me qëllim që të gjitha dokumentet, të cilat, me djepi të këtij autoriteti, janë të nevojshme për të çmuar kërkesën, t'i bashkëngjiten kësaj. Ai ndihmon gjithashtu kërkuesin eventualisht për përkthimin e nevojshëm të dokumenteve.

Ai mund të refuzojë të transmetojë kërkesën në rast se kjo i duket atij krejtësisht e kotë.

2. Autoriteti qendror marrës i transmeton dosjen autoritetit kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën. Ai njofton autoritetin dërgues për të gjitha vështirësitë lidhur me shqyrtimin e kërkesës, si dhe me vendimin që ka marrë autoriteti kompetent.

Neni 4

Dokumentet e transmetuara në zbatim të kësaj Marrëveshjeje nuk kanë nevojë për legalizim dhe për asnjë formalitet analog.

Neni 5

Asnjë pagesë nuk do të bëhet nga Palët kontraktuese për shërbimet e kryera konform kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

1. Me rezervën e rregullimeve të veçanta të arritura midis autoriteteve të interesuara të Palëve kontraktuese dhe të dispozitave 13 e 14:

a. Kërkesa për ndihmë gjyqësore dhe dokumentet që e shoqërojnë, si dhe çdo komunikim hartohen në gjuhën ose në një gjuhë zyrtare të autoritetit marrës ose shoqërohen me përkthim në këtë gjuhë;

b. Çdo Palë kontraktuese duhet megjithatë të pranojë kërkesën për ndihmë gjyqësore dhe dokumentet që e shoqërojnë, si dhe çdo komunikim kur ato janë hartuar në gjuhën angleze ose franceze, ose kur ato shoqërohen me përkthim në njërin nga këto gjuhë.

2. Komunikimet që bëhen nga Shteti i autoritetit marrës mund të hartohen në gjuhën ose në njërin nga gjuhët zyrtare të këtij Shteti, ose në anglisht ose frëngjisht.

Neni 7

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, autoritetet qendrore të Palëve kontraktuese detyrohen të njoftojnë reciprokisht njëri-tjetrin për gjendjen e legjislacionit në fushë të ndihmës gjyqësore.

Neni 8

Autoritetet e përmendur në nenin 2 caktohen me anë të një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në çastin kur Shteti përkatës bëhet palë në Marrëveshje konform dispozitave të neneve 9 e 11. Çdo ndryshim lidhur me kompetencën e këtyre autoriteteve do të jetë gjithashtu objekt i një deklaratë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim për Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, të cilët mund të bëhen palë me atë të:

- a. nënshkrimit pa rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi;
- b. nënshkrimi me rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi, që pasohet nga ratifikimi, pranimi ose miratimi.

2. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

Neni 10

1. Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi një muaj pas datës në të cilën dy Shtetet anëtare të Këshillit të Europës janë bërë palë në Marrëveshje konform dispozitave të nenit 9.

2. Për çdo Shtet anëtar që do ta nënshkruaj më pas pa rezervë ratifikimi, pranimi ose miratimi, ose do t'a ratifikojë, pranojë ose miratojë, Marrëveshja do të hyjë në fuqi një muaj pas datës së nënshkrimit ose të depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit ose të miratimit.

Neni 11

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mund të ftojë çdo Shtet jo anëtar i Këshillit të Europës për të aderuar në këtë Marrëveshje.

2. Aderimi bëhet me depozitim, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të instrumenteve të aderimit që do të ketë efekt një muaj pas datës së depozitimit të tyre.

Neni 12

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e nënshkrimit ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, të caktojë territorin ose territoret ku do të zbatohet kjo Marrëveshje.

2. Çdo Shtet mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit ose në çdo çast tjetër më pas, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës, të shtrijë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje në çdo territor tjetër të përmendur në deklaratë dhe në të cilin ai mbulon marrëdhëniet ndërkombëtare ose për të cilin ai është i autorizuar t'i kryejë. Shtrirja ka efekt një muaj pas dorëzimit të deklaratës.

3. Çdo deklaratë e bërë sipas paragrafit të mëparshëm mund të tërhiqet, lidhur me territorin e caktuar në deklaratë, me notifikim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Kjo tërheqje do të fillojë efektet gjashtë muaj pas datës së marrjes të notifikimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 13

1. Çdo Shtet mundet, në çastin e depozitimit të instrumenteve të ratifikimit, të pranimit, të miratimit ose të aderimit, të deklarojë përjashtimin e zbatimit tërësisht ose pjesërisht të dispozitave të nenit 6, paragrafi 1.b. Asnjë rezervë tjetër nuk pranohet për këtë Marrëveshje.

2. Çdo palë kontraktuese mund të tërheqë tërësisht ose pjesërisht rezervën që ajo ka bërë, me anë të një deklarate drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës. Efektet e rezervës do të

pushojnë në datën e marrjes së deklaratës.

3. Kur një Palë kontraktuese bën një rezervë, çdo Palë tjetër mund të zbatojë të njëjtën rezervë ndaj kësaj Pale.

Neni 14

1. Çdo Palë kontraktuese që ka disa gjuhë zyrtare mundet, për efekt të zbatimit të nenit 6, paragrafi 1.a, të bëjë të ditur, me anë të një deklaratë, gjuhën në të cilën kërkesa dhe dokumentet që e shoqërojnë do të duhet të hartohen ose të përkthehen me qëllim të transmetimit të palët e territorit që ajo ka përcaktuar.

2. Deklarata e parashikuar në paragrafin e mësipërm do t'i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës në çastin e nënshkrimit të Marrëveshjes nga Shteti i interesuar ose në çastin e depozitimit të instrumenteve të saj të ratifikimit, të pranimi, të miratimit ose të aderimit. Deklarata mund të tërhiqet ose të modifikohet kurdoherë më pas sipas së njëjtës procedurë.

Neni 15

1. Çdo Palë kontraktuese mundet, përpara i takon, të denoncojë këtë Marrëveshje duke i drejtuar një notifikim Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Europës.

2. Denoncimi do të fillojë efektet gjashtë muaj pas datës së marrjes së notifikimit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

Neni 16

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u notifikojë Shteteve anëtarë të Këshillit të Europës dhe çdo Shteti që ka aderuar në këtë Marrëveshje:

- a. çdo nënshkrim pa rezervë të ratifikimit, të pranimi ose të miratimit;
- b. çdo nënshkrim me rezervë të ratifikimit, të pranimi ose të miratimit;
- c. depozitimin e çdo instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi;
- d. çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 8;
- e. çdo datë të hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, konform nenit 10 të saj;
- f. çdo deklaratë të marrë në zbatim të paragrafeve 2 e 3 të nenit 12;
- g. çdo deklaratë të marrë në zbatim të paragrafit 1 të nenit 13;
- h. tërheqjen e çdo rezerve të bërë në zbatim të dispozitave të paragrafit 2 të nenit 13;
- i. çdo deklaratë të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 14;
- j. çdo notifikim të marrë në zbatim të dispozitave të nenit 15 dhe datën në të cilën denoncimi do të fillojë efektet.

Me këtë mirëbesim, nënshkruesit, të autorizuar rregullisht për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Strasburg, më 27 janar 1977, në frëngjisht dhe anglisht, të dy tekstet janë njëllor të besueshëm, në një ekzemplar të vetëm që do të depozitohet në arkivat e Këshillit të Europës. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës do t'u komunikojë nga një kopje të vërtetuar konform secilit nga Shtetet anëtare nënshkrues dhe aderues.

L I G J
Nr.8706, datë 1.12.2000

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “MARRËVESHJEN E PJESSHME TË ZGJERUAR TË QENDRËS EUROPIANE TË GJUHËVE MODERNE”, NË GRAZ TË AUSTRISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Marrëveshjen e pjesëshme të zgjeruar të qendrës europiane të gjuhëve moderne”, në Graz të Austrisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2830, datë 8.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

REZOLUTA (98)11

Për vazhdimësinë e Qendrës Evropiane të Gjuhëve Moderne
(miratuar nga Komiteti i Ministrave më 2 korrik 1998,
në mbledhjen e 638-të të zv/Ministrave)

Përfaqësuesit e Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare të Marrëveshjes së Pjesëshme, të cilat themeluan Qendrën Evropiane të Gjuhëve Moderne(QEGJM):

Andora, Austria, Bullgaria, Kroacia, Qipro, Republika Çeke, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Hungaria, Islanda, Letonia, Lihtenshtein, Luksemburg, Malta, Hollanda, Norvegjia, Polonia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Zvicra, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë,

- Duke u bazuar në Rezolutën Statuore (93) 28 të Komitetit të Ministrave mbi Marrëveshjet e Pjesëshme dhe të Zgjeruara;
- Duke u bazuar në Rezolutën (94) 10 të Komitetit të Ministrave, datë 8 prill 1994, për ngritjen e QEGJM për një periudhë fillestare prej tre vjetësh, në përfundim të së cilës do të rishikohej funksionimi i Qendrës me synimin për të vendosur mbi vazhdimësinë e aktivitetit të Qendrës pas asaj date,
- Duke u bazuar në vendimin e Komitetit të Ministrave për të shtyrë periudhën fillestare të QEGJM deri në 31 dhjetor 1998;
- Duke pasur parasysh konkluzionet e vlerësimit të jashtëm për aktivitetet dhe funksionimin e

Qendrës, të kryera nga një komitet i përbërë nga pesë ekspertë të pavarur të caktuar nga bordi drejtues;

- Duke pasur parasysh funksionet e ndryshme të Seksionit të Gjuhëve Moderne në KE dhe QEGJM, si dhe bashkëpunimin që duhet të realizohet nga këto dy instanca;
- Duke u bazuar në opinionin dhe rekomandimet e Bordit Drejtues të Qendrës të formuluar në takimin e 6-të të saj më 23-24 shkurt 1998 në favor të vazhdimësisë së QEGJM;
- Të bindur që vazhdimësia e aktiviteteve të QEGJM do të kontribuojë ndjeshëm në kuadrin e bashkëpunimit kulturor dhe respektimit të diversitetit të pasur dhe kulturor në Evropë;

Vendosën të konfirmojnë vazhdimësinë e aktiviteteve të QEGJM nëpërmjet Marrëveshjes së Zgjeruar të Këshillit të Evropës. QEGJM do të udhëhiqet nga Statuti bashkëngjitur. Shërbimet dhe aktivitetet e Qendrës do të vlerësohen në intervale të rregullta, në përputhje me kushtet dhe kalendarin e vendosur nga bordi drejtues. Raportet e vlerësimit do t'i përcillen Komitetit të Ministrave.

Aneksi i Rezolutës

Statuti i Qendrës Evropiane të Gjuhëve Moderne

Neni 1

Në kuadrin e bashkëpunimit kulturor dhe respektimit të diversitetit të pasur lingvistik dhe kulturor në Evropë, Qendra ka si mision të saj:

- Zbatimin e politikave gjuhësore
- Nxitjen e metodave rinovuese për të mësuarin dhe mësimdhënien e gjuhëve moderne.

Objektivat strategjike të Qendrës janë:

- Të fokusohet në praktikën e të mësuarit dhe mësimdhënies së gjuhëve moderne;
- Të nxisë dialogun dhe shkëmbimin midis partnerëve të ndryshëm në këtë fushë;
- Të trainojë formatorët;
- Të mbështesë rrjetet që bazohen në program dhe projektet kërkimore.

Për realizimin e objektivave strategjike, Qendra i ka vënë vetes këto objektiva operuese:

- Të mbledhë dhe shpërndajë shembuj të praktikës së mirë në fushën e të mësuarit dhe mësimdhënies së gjuhëve moderne;
- Të organizojë takime (workshop-e, kolokiume etj) me pjesëmarrjen e formatorëve të mësuesve, autorëve të teksteve, ekspertëve në fushën e zhvillimit të kurrikulave, standardeve arsimore dhe metodave të vlerësimit dhe çertifikimit, kërkuesve dhe hartuesve të politikave arsimore nga e gjithë Evropa, specialistëve të teknologjive të reja;
- Të fokusohet në shpërndarjen dhe vazhdimin e aktiviteteve, si dhe të zhvillojë më tej dokumentacionin dhe burimet e Qendrës.

Neni 2

1. Çdo shtet që është anëtar i KE ose i Konventës Kulturore Evropiane mund të anëtarësohet në Marrëveshje në çdo kohë duke njoftuar Sekretariatit e Përgjithshëm të KE.

2. Komiteti i Ministrave, në përbërje të të cilit janë në mënyrë të kufizuar vende anëtare të Marrëveshjes së Zgjeruar (më poshtë referuar si Komiteti i Ministrave), mund të vendosë për të ftuar dhe vende joanëtare për t'u anëtarësuar në Marrëveshjen e Pjesëshme të Zgjeruar, në vijim të konsultimeve të vendeve joanëtare që aktualisht marrin pjesë në të.

Neni 3

1. Bordi Drejtues i Qendrës do të përbëhet nga një përfaqësues i çdo vendi anëtar në Marrëveshje.

Një përfaqësues nga shoqata austriake, referuar në nenin 7.3 mund të marrë pjesë në punimet e Bordit Drejtues si vëzhgues.

2. Bordi Drejtues do të zgjedhë nga anëtarët një Byro të përbërë nga një Kryetar, dy nënkryetarë dhe dy anëtarë të tjerë të caktuar për një periudhë prej dy vjetësh.

Neni 4

1. Bordi Drejtues do të:

- Miratojë programin kuadër afat-mesëm të aktiviteteve të Qendrës;
- Monitorojë zbatimin e programit të aktiviteteve dhe menaxhimin e financës së Qendrës;
- Miratojë dhe përcjellë në Komitetin e Ministrave një raport vjetor mbi aktivitetin e Qendrës, i cili do të përmbajë dhe një pasqyrë të aktiviteteve të ardhshme, përfshi dhe treguesit buxhetorë.

2. Vendimet e Bordit drejtues do të merren nga dy të treta e shumicës së votave. Çështjet proceduriale do të vendosen me shumicë votash.

3. Bordi Drejtues do të mblidhet të paktën një herë në vit, në Strasburg ose në Grac.

4. Bordi Drejtues do të miratojë Rregullat e Procedurës së vet, si dhe rregulla të tjera që udhëheqin funksionimin e Qendrës.

Neni 5

1. Byroja do të:

- Monitorojë ekzekutimin e programit afatmesëm të miratuar nga bordi drejtues;
- Miratojë programin vjetor të aktiviteteve dhe do të monitorojë zbatimin e tij;
- Përgatisë takimet e bordit drejtues;
- Të kryejë detyra të ngarkuara nga Bordi Drejtues.

2. Byroja do të mblidhet dy ose tri herë në vit.

Neni 6

1. Shpenzimet e lidhura me zbatimin e programit të aktiviteteve dhe shpenzimet e përbashkëta të sekretariatit do të mbulohen nga buxheti i marrëveshjes së pjesshme të financuar nga shtetet anëtare dhe joanëtare dhe pjesëmarrëse në Marrëveshjen e Pjesshme të Zgjeruar.

2. Buxheti dhe shkalla e kontributeve do të miratohet nga një organ i përbërë nga përfaqësues të Komitetit të Ministrave të vendeve anëtare të Marrëveshjes së Pjesshme të Zgjeruar dhe, kur nevojitet, nga përfaqësues të vendeve joanëtare të cilat do të zgjidhen me anë të votës.

3. Përveç kësaj Qendra mund të pranojë kontribute vullnetare ose të tjera të cilat do të paguhen në një llogari të veçantë të hapur në bazë të Nenit 4.2 të Rezolutës Financiare të Këshillit të Evropës. Këto kontribute mund të përdoren për një qëllim të veçantë.

4. Rregullat Financiare do të zbatohen me miratimin dhe menaxhimin e buxhetit të Qendrës.

Neni 7

1. Republika e Austrisë do të caktojë falas një godinë dhe një sekretariat në dispozicion të Qendrës.

2. Shpenzimet në lidhje me sekretariatën lokal dhe menaxhimin e Qendrës do të mbulohen nga Republika e Austrisë.

3. Republika e Austrisë mund t'ia besojë ekzekutimin e detyrimeve të këtij neni një shoqate në përputhje me ligjin austriak të krijuar për këtë qëllim.

Neni 8

1. Sekretariati i Qendrës, nën përgjegjësinë e një drejtori, do të ngrihet nga Sekretariati i Përgjithshëm i KE.

2. Drejtori mund t'i bëjë thirrje institucioneve të mirënjohura dhe ekspertëve të pavarur në mësimdhënien dhe mësimin e gjuhëve moderne.

3. Staf i ngritur nga autoritetet austriake në zyrat e Qendrës nuk do t'i përkasë stafit të KE.

4. Godina e Qendrës do të jetë në Grac.

Neni 9

Komiteti i Ministrave mund të miratojë amendamente të këtij Statuti me shumicën e parashikuar nga Neni 20.d i Statutit të KE.

D E K R E T

Nr.2831, datë 11.12.2000

PËR LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik

D E K R E T O J:

Neni 1

U hiqet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Eduard Bado Shakaj
2. Liljana Filip Benz (Isaia)
3. Ajet Petrit Shema
4. Stewen Ajet Shema
5. Peggy Ajet Shema
6. Alma Shyqyri Shema (Çepele)
7. Albert Pandi Gjore
8. Sara Albert Gjore
9. Vanessa Albert Gjore
10. Lindita Rexhep Gjore (Fekollari)
11. Elisabeta Fadil Werner (Pruthi)
12. Artur Rrapo Sulaj
13. Kastriot Zubihi Dalani
14. Artur Sokrat Rushi
15. Olsi Muhamet Ferzaj

16. Ylli Zeqo Beqiraj
17. Hafize Faslli Beqiraj (Fetahu)
18. Azem Besim Karami
19. Vjosana Azem Karami
20. Erjon Azem Karami
21. Besim Azam Karami
22. Kliton Sokol Gashi
23. Gjon Nush Radovani
24. Odeta Nuri Mehmetaj
25. Alfred Mersin Halo
26. Katharina Alfred Halo
27. Albana Spartak Halo (Luga)
28. Mercedes Bego Alushi
29. Inva Avni Aliko
30. Alban Avni Aliko
31. Neptun Sazan Mara
32. Cansu Neptun Mira
33. Irem Neptun Mira
34. Saimir Shemshi Mataj
35. Adrian Gani Pineti
36. Enado Adrian Pineti
37. Enkeleida Petro Ekonomi (Zisi)
38. Kostandin Roland Ekonomi
39. Manuel Roland Ekonomi
40. Benjamin Roland Ekonomi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

KËRKESË
(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Kërkuesi: Abdulla Hakorja, i biri i Selimit dhe i Zeqijes, lindur në Brezhdan të Komunës Qendër dhe banues në Peshkopi.

Objekti: Shpalljen e zhdukjes së djalit tim Atli Hakorja, në bazë të neneve 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Unë kërkuesi Abdulla Hakorja, kërkoj të shpallet i zhdukur djali im, Atli Hakorja. Në 9 mars 1996 u nis me motoskaf në Itali. Nga data e nisjes kanë kaluar shumë vite, ne si prindër dhe gruaja e tij nuk kemi asnjë informacion për vendndodhjen e tij. Sa më sipër kërkoj nga Gjykata të shpallet i zhdukur djali im, Atli Hakorja.

KËRKUESI
Abdulla Hakorja

KËRKESË
(Për shpallje të zhdukur)

Kërkesë: Eshref Fida, i biri Mirvetit dhe Beres, lindur dhe banues në Fshatin Grevë të Komunës Melan.

Objekti: Deklarimin të zhdukur të djalit tim Gjyzel Fida, në bazë të neneve 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Unë kërkuesi Eshref Fida, kërktoj të shpallet i zhdukur djali im, Gjyzel Fida. Në 9 mars 1996 ai u nis me gomone në Itali. Në këto kushte, meqë është e pamundur që të marrim vesh se ku ndodhet djali ynë Gjyzel Fida, kërktoj nga Gjykata të shpallet i zhdukur.

KËRKUESI
Eshref Fida

KËRKESË
(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Kërkuesi: Angje Pjetri, e bija e Shtjefnit dhe Shukes, lindur në Dajç, banuese në Shkodër.

Objekti: Shpalljen e zhdukjes së djalit tim, Françesk Pjetri, në bazë të neneve 375, 376 të Kodit të Procedurës Civile.

Unë kërkuesja Angje Pjetri, kërktoj të shpallet i zhdukur djali im Françesk Pjetri. Në mars të vitit 1993, djali im është larguar dhe prej tij nuk kam asnjë njoftim. Sa më sipër kërktoj nga gjykata të shpallet i zhdukur djali im Françesk Pjetri.

KËRKUESE
Angje Pjetri

VENDIM
(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Gjykata e rrethit Gramsh, konform nenit 306, 375 të Kodit të Procedurës Civile vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Tahir Balliu si dhe caktimin si kujdestar për administrimin e pasurisë së tij, bashkëshorten Valbona Balliu.

VENDIM
(PËR SHPALLJE TË ZHDUKUR)

Gjykata e rrethit Shkodër, konform nenit 306, 375 të Kodit të Procedurës Civile vendosi shpalljen të zhdukur të Ilirian Vehib Kacaj.

Fletorja Zyrtare gjendet në:

1. Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
2. Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 10.11.2000
Doli nga shtypi më 13.11.2000

Tirazhi: 3700 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Çmimi: 150 lekë